

Kritika - Dorëshkrim



SHEVKI SH. VOÇA

Përkujtim me rastin e lindjes dhe vdekjes së profesor magjistër Ahmet Sh. Maloku (1929-1999)

*Jetën e ndriçon kandili i vdekjes
V. A. KOSKENEM*

Vitin që e lamë pas u mbushën plotë tetë dhjet vjet nga lindja, dhe dhjetë vjet nga vdekja e profesor magjistër Ahmet Sh. Maloku, intelektualit, pedagogut, profesorit në lëndët e kimisë dhe fizikës, këshilltarit në Entin për Përparimin e Shkollave të Kosovës, drejtorit të shkollës së parë të pavarur të Normales “Hasan Prishtina” në Mitrovicë, aktivistit të pa lodhur në pajtimin e gjaqeve etj. Fusha e veprimtarisë dhe aktivitetit të tij kapë një hapësirë të gjerë të vokacionit. Ai merrej edhe me profesione tjera shkencore në të cilat ishte shumë i suksesshëm si bie fjala me etnografi, poezi, publicistik, histori e



posaçërisht me atë të kulturës kombëtare. Veçanërisht njohuria e tij dallohej për rrjedhat shoqërore politike të historisë së Mitrovicës me rrethinë gjatë shekujve. Gjatë jetës sa rroi u dallua për patriotizëm dhe dashuri ndaj kombit me çka u dëshmuua sa ishte gjallë në luftën që bënte aso kohe me lajkatarët dhe hileqarët të cilët ishin bërë vegla të pushtetit serbo-komunist dhe të cilët nuk mund ta shihnin veten jashtë veprave të mbrapshta që i sillnin kombit shqiptar. Profeshori i nderuar nuk lëshonte pe dhe nuk pranonte kurrfarë kompromisi që vinte ndeshë me interesat kombëtare, ani pse kjo i kushtoi shumë në jetë, me që në vitin 1970, e largojnë nga puna ku ishte duke ushtruar detyrën e drejtorit të shkollës së mesme normale “Hasan Prishtina” në Mitrovicë, themelues i së cilës siç thamë ka qenë ai vetë, për çka do të bëjmë fjalë më shumë në vijim të këtij shkrimi. Po në këtë interval kohor Shkolla e L. P.

AHMET SH. MALOKU (1929-1999) e Prishtinës e kishte hapë katedrën për kimi-fizik, pranë SH. L. Teknike në Mitrovicë, ku profesori i nderuar Ahmet Maloku si ekspert që

ishite ligjëronte lëndët, kimi inorganike, kimi organike dhe metodikën e kimisë, dhe që as këtë detyrë nuk e lanë ta ushtroi, përkundët aftësive dhe njohurive të tija shkencore dhe pedagogjike. Një gjë që e kishte munduar më së shumti siç më tregonte profesori në njërin nga shumë biseda të zhvilluara që bëja me te ishte se nuk mund të besonte që nga frika e organeve të pushtetit komunist e kishin izoluar tërësisht shoqëria dhe të afërmit të cilët për më tepër se një vit sa kishte mbetur pa punë nuk kishin pas guxim ta përshëndesin rrugës e lere më që dikush ta vizitonte në shtëpi. Brenda kësaj kohe sipas rrëfimeve të tija, i vetmi njeri që e vizitonte kohë pas kohe dhe i ndihmonte nga pak ishte Bajram Voca (tani në moshën 80 vjeçare, djali më i vogël i Sherif Vocë-s 1893-1941, ish deputetit në parlamentin e Jugosllavisë mbretërore i cili mbeti në histori i njohur me fjalimet e tija në po këtë parlament midis Beogradit kundër kolonistëve serbo malazet që me anë të reformave agrare asokohe ua morën me dhunë shqiptarëve tokat dhe vendet më të mira, si dhe dhunës që ua sillnin shqiptarëve në bashkëpunim me organet e pushtetit, me qëllim të shpërngulje së shqiptarëve në Turqi, për të cilin profesor Ahmet Maloku kishte shkruar një shkrim në gazetën “Rilindja” botuar më 3-XII-1967, pl. Sh. V.). Profesori nuk ia kishte frikën askujt, shpesh thoshte mirë thotë populli: “Frikacaku as dynjanë as ahiretin.” Kishte një guxim dhe vendosmëri të pa shoq në aspektin intelektual, çka ja forconte qëndrimin e tij burror. Me një diapazon të gjerë të diturisë dhe me një memorie të jashtëzakonshme, ai aspak nuk i përtonte dhe nuk i shmangej polemikave dhe bisedave nëpër kuvende dhe takime të ndryshme qoftë edhe me njerëz të pozitës dhe elitës politike të pushtetit.

Pr. Mr. Ahmet Maloku u lind më 21 janar të vitit 1929, por babai i tij Shaqir Maloku e kishte regjistruar tre vjet më vonë, ashtu që nëpër dokumentacione të shumta zyrtare datëlindja e tij figuron 22 dhjetor 1932, në Mitrovicë. Disi kishte qenë si traditë që baballarët dhe gjyshërit tanë pas pushtim serbo-sllav të Kosovës, fëmijët mashkull ti regjistronin nëpër libra të amzës nga dy apo tre vjet pas lindjes që me rastin e shkuarjes ushtar të tregohen më të pjekur. Ahmeti rrjedhke nga një familje patriotike dhe atdhedashëse. Hajdar Maloku (gjyshi i gjyshit të profesor Ahmet Malokut) qysh në vitin 1834, gjatë kohës së Tanzimatit syrgjynosët nga organet e pushtetit të atëhershëm në Kurshumli Han të Shkupit ku sëmuret dhe vdes. Djali i tij Muhamed Maloku në vitin 1881, pushkatohet në kazermën e ushtresë në Mitrovicë, si rezistues dhe ithtar i Lidhjes së Prizrenit. Djali i Muhamedit, Ahmeti (emrin e të cilit e mbante profesori i ndjerë për të cilin ne bëjmë fjalë) në vitin 1914 u pushkatua me gjithë gruan dhe dy fëmijët, djalin 11 vjeçar dhe vajzën 8 vjeçare. Ndërsa babai i profesorit, emri i vërtetë i të cilit ka qenë Muhamed, ripërtëritje e emrit të gjyshit të pushkatuar në kazermën ushtarake të Mitrovicës që cekëm më parë arrin ti ik kësaj plobe dhe strehohet te dajat në fshatin Zhabar pranë Mitrovicës, i cili edhe e ndërton emrin nga Muhamed në Shaqir, për të mos u zbuluar nga kriminelët që ja kishin vra dhe pushkatuar tërë familjen. Në fshatin Zhabar qëndron deri në vitin 1927, kur zbret në qytet në Mitrovicë, (informatë nga profesor Ahmet Maloku me 27-VIII-1992, enjte në prani të Ihsan Çazim Kalaveshi 54 vjeçar. Për rastin e babës së Ihsanit dhe të dy bashkëqytetarëve të tij nga Mitrovica të cilët u vranë në Leshak nga serbo çetnikët gjatë luftës dytë botërore do të bëjmë fjalë më vonë). Ahmet Maloku shkollën fillore pesëvjeçare e kryen në vendlindje, kurse gjimnazin e ulët dhe semimaturën e përfundon në Prishtinë, pranë gjimnazit “Ivo Lolla Ribar”. Në vitin 1950 diplomon në shkollën normale në Pejë. Në këtë vit shkollor është shpallë nxënësi më i mirë, për çka asokohe pati shkruar edhe “Rilindja”, ku në mes tjerash thuhej: “Nxënësi

më i mirë në paralele të Normales dhe të kursit të lartë që diplomuan në Pejë, më 1950, u shpall Ahmet Shaqiri”, (këtë mbiemër profesor Ahmet Maloku e mbajti deri në vitin 1950, shih në prof. Mr. Ahmet Maloku “ENCIKLOPEDIK I VOGËLTH-politiko-etnologjiko-historike”, Prishtinë 1998, faqe 112). Studimet e larta pedagogjike në grupin fizik, kimi dhe matematik i vazhdoi në Beograd, ku në vitin 1952 edhe diplomon, ndërsa provimin profesional pranë Shkollës Lartë Pedagogjike po këtu në Beograd e jep më 1954. Sipas rrëfimeve të tija dhënë autorit të këtyre rreshtave, në SHLP në Beograd në grupin për kimi, fizik dhe matematikë ishin regjistruar përmbi 110 studentë, prej të cilëve në vitin e dytë kalojnë vetëm 24. Nga ky grup i vetmi shqiptar ishte Ahmet Maloku, ai i pari edhe kishte diplomuar në afat të rregullt, një karakteristikë e veçuar e inteligjencës së tij. Më vonë i vazhdon studimet dhe në vitin 1964 diplomon pranë fakultetit filozofik të Prishtinës, në grupin për kimi (aso kohe ishte dega e Universitetit të Beogradit). Të gjitha i ka kryer me sukses të shkëlqyeshëm. Ka qenë nxënësi dhe studenti më i dalluar në shkollë dhe në studime. Në lidhje me këtë më kujtohet një rast kur në shkurtin e vitit 1986, në Brezovicë aso kohe kishim shkuar për kurim një grup i punëtorëve të shkritores së plumbit të Zveqanit, për pushime dhjetë ditore në kuadër të sindikatës e cila organizonte dërgimin e punëtorëve prej shtatë deri në dhjetë ditë në Brezovicë si një vend me ajër të pastër dhe të fortë, shumë i përshtatshëm për pastrimin e gjakut dhe forcimin e organizmit nga kushtet e rënda të punës në shkritoren e plumbit në Zveqan. Aty vinin njerëz nga vise të ndryshme të ish Jugosllavisë komuniste për të shijuar ajrin dhe ambientin e pastër e cila pas një qëndrimi të shkurtë prej disa dite bënte ndryshimin e fotografisë së gjakut në tërësi. Këtu mu dha rasti të njoftohem me profesor doktor Mazlum Cana, ligjërues i lëndës së matematikës në fakultetin e xehetarisë dhe të metalurgjisë në Mitrovicë, (vëllai i profesorit të ndjerë të historisë dr. Zekeria Cana pl. SH. V.), i cili po ashtu kishte arritur që disa ditë pushimi t’i kaloi në këtë vend mjaftë atraktiv. Me që profesori e kuptoi se aty kishim arritur një grup punëtor të profesioneve të ndryshme për kurim nga Mitrovica, ai shprehi dëshirë që nga i gjithë ai grup prej 45 vetave sa ishim të shfrytëzojë rastin dhe të kaloi të paktën ca momente me ndonjërin prej nesh. Dhe një mëngjes kur shkuam në sallën e ushqimit ku i zinte rreth 75 deri 80 vetë, pa prit mas më preku dikush në anën e djathtë të krahut duke më thënë eja këtu tek tavolina ime ja e sheh që është një ulëse e zbrastë ta kalojmë këtë mëngjes bashkë dhe të bisedojmë pak. Në bisedë e sipër profesori më pyeti se cilës familje nga Mitrovica i takoi? Pasi iu prezantova dhe i tregova në cilën pjesë të qytetit banojë, ai më tha: Por, ju Vocët një pjesë jetoni në qytet ndërsa një pjesë e madhe e kushërinjve të juaj më duket ende jetojnë në fshat. A e kam mirë më tha? Iu përgjigja me po. Pasi më pyeti për emrin e babait, nuk priti gjatë dhe menjëherë më tha: “Po, po, më kujtohet se ku gjendet shtëpia juaj, sepse aty dikur banonte me qira gjakovari Asllan Kryeziu (ish arsimtar i muzikës në shkollën fillore Abdulla Shabani pl. SH. V.) apo, a jo”? Po profesor, iu përgjigja. Arsimtari Asllan Kryeziu, ka banuar në shtëpinë tonë me qira plot shtatë vite, prej tetorit të vitit 1969 e deri në tetorin e vitit 1976, kur ministria e arsimit të kuvendit komunal ia ndau një banesë, iu përgjigja. Në bisedë e sipër profesor Cana më pyeti a mos e njoh rastësisht Ahmet Malokun, pasi që jam nga Mitrovica. I thash jo, personalisht nuk e njoh, përndryshe kamë dëgjuar mjaft për te. Më tha çka ke dëgjuar ? I tregova se më duket diku kah fundvitet e gjashtëdhjetave dhe në fillim të viteve të shtatëdhjeta emri i tij ka qenë shumë i njohur dhe përmendur gati nëpër çdo shtëpi në Mitrovicë. Të paktën më kujtohet se në shtëpinë tonë shumë shpesh burrat e përmendnin për trimërinë, burërinë dhe

qëndrueshmërinë intelektuale të tij. Atëherë profesor Cana më tha: “Mu këtë desha ta dëgjoj nga ju, dhe vazhdojë të më rrëfej për profesor Ahmet Malokun duke i shkoqitur disa detaje nga koha e studimeve në Beograd, me çrrastë unë për lexues të nderuar do ta veçoja vetëm një”. “ Ahmet Maloku dukshëm dallohej nga të gjithë studentët tjerë për diturin, zgjuarsinë dhe inteligjencën e tij. Me që Maloku studionte në grupin për fizik dhe kimi ndërsa unë isha në matematikë, por kishte raste kur i njëjti profesor ligjëronte në të dy grupet, ashtu që me një rast njëri nga profesorët (nëse nuk më tradhton kujtesa bëhej fjalë për profesorin shumë serioz të Universitetit të Beogradit me emrin Bozho Tezhak, të cilin vite më vonë edhe profesor Ahmeti shumë shpesh ma ka përmend, por në kontekst tjetër duke ia shtuar atributin e masonit Sh. V.) iu drejtua disa studentëve serb me këto fjalë: “Sramota, neznalice, lenji, idite kod onog shiptara iz Mitrovice da vas uci i odrzi predavanje”, (turp, të pa dijshtëm, përtac shkoni tek ai shqiptari nga Mitrovica që të ju mësoj dhe mbaj ligjërata).” Kjo ishte vetëm një detal, ndërsa profesor Cana më tregoi edhe raste tjera për dituritë e profesor Ahmet Malokut. Shumë vite më vonë një qytetar i Mitrovicës, Isak Mustaf Vitaku, i cili shumë shpesh më shihte në shoqëri me profesor Ahmet Malokun, më pati treguar se në shkollën fillore në Mitrovicë katër vjet e kishte pas Ahmetin shokë klase, dhe shtonte se nuk ka pas nxënës ma të zgjuar dhe ma të mirë se ai. Axha Isak (është ende gjallë dhe jeton në Mitrovicë) më thoshte: “Shpesh po të shoh në shoqëri me Ahmetin, e po më intereson të dijë çka po ju bashkon aq shumë, kurse dihet se për nga mosha ju ndanë një distancë e madhe kohore.” Përgjigja ime ishte se informatat dhe diturinë që po e kërkoj moshatarët e mi si dhe ata më të vjetër se unë, por, edhe se profesor Ahmeti nuk po din të më tregojnë, ndërsa ai sa po mundem me vlerësua në aspektin e inteligjencës dhe informatave që i posedon dukshëm dallohet nga qytetarë tjerë të Mitrovicës. Atëherë axha Isak pa hamendje më tha: “Po qe besa rri me Ahmetin, se ai din shumë e shumë gjëra me ti tregu, sepse është edhe i mençur por edhe shumë i lexueshëm” (bisedë e zhvilluar më 9 maj, enjte 1991 pas dite, pranë tregut në Mitrovicë), për ç’gjë unë edhe u vërtetova pasi që prej janarit të vitit 1991 e deri një javë para luftës së Kosovës, kontaktet dhe ndejat e mija me profesor magjistër Ahmet Malokun ishin shumë të shpeshta.

Profesor Ahmet Maloku studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematikore në Universitetin e Zagrebit, ku në vitin 1975 mbrojti edhe temën e magjistraturës. Edhe pse kishte aftësi dhe potencial të rast intelektual, ai shkollimin e mëtutjeshëm akademik nuk e vazhdoi, ani pse mund të doktoronte kur të doje. Kur e botoi librin e parë publicistikë “Ata gabo unë qorto I”, (prill, 1996), menjëherë pas ca dite më vizitojë në shtëpinë time në Mitrovicë dhe ma dhurojë librin e po sa botuar. Më tha së shpejti do të botohet edhe pjesa e dytë i këtij vëllimi. At ditë ishte e premte, 3 maj 1996, dhe nuk ndejti shumë si herëve tjerë që zhvillonte biseda nga të ndryshmet me mua, ndërkaq që unë e shfrytëzova rastin dhe e pyeta: “Se ku qëndron shkaku për mos vazhdimin e mëtutjeshëm të shkollës deri tek grada e doktoraturës?” Me që vërehej se ai kishte dituri dhe diapazon tepër të gjerë të njohurive të ndryshme, kurse profesionin që e kishte nuk do ti paraqite kurrfarë pengese në këtë drejtim. Profesori njëherë ofshau thellë, pushoi ca sekonda sa të mendoja unë se e hidhërova me këtë pyetje. Pastaj vazhdoi dhe më tha: “O Shevki Voca, ëndrra ime e jetës u përmbys që nga viti 1970, atëherë kur më larguan nga puna dhe nga çdo aktivitet i jetës. Dëshira ime e flaktë ka qenë të punoj në arsim deri te shkallët më të larta të shkollimit, që ti edukoj dhe mësoj brezat e ri të kombit tonë jo vetëm në aspektin profesional por edhe në aspektin e zgjerimit të diturisë dhe

njohurive të ndryshme, me një fjalë që të posedojnë një kulturë sa më të gjerë. Që nga radhët e tyre të dalin njerëz të cilët në paktën do ti afroheshin një eruditi siç kanë qenë Faik Konica, Lasgush Poradeci, (këtë e çmonte jashtëzakonisht shumë), Eqrem bej Vlora (për këtë aso kohe unë fare pak kisha informata), Spiro Konda (për të cilin flitet se ka poseduar një bibliotekë personale gjigante pl. Sh. V.), Eqrem Qabej e disa të tjerë që nuk vazhdoi më tutje.”

Karrierën e punës e kishte filluar në arsim gjatë viteve 1949-1950, në fshatin Elezaj (Doganaj) ku kishte formuar shkollën tetë vjeçare. Këtu qëndrojë një vit e gjysmë duke kryer punën e mësuesit, arsimtarit dhe të drejtorit të shkollës. Gjatë viteve 1953/54 profesor Ahmet Malokun e gjejmë në detyrën e mësimit në lëndët fizik dhe kimi në gjimnazin e Prishtinës, “Ivo Lolla Ribar”, ku si kuadër deficitar dhe me aftësi të rralla ia kishin siguruar banesën pa pagesë. Vitet 1954-1961, si profesor i rregullt ai i kaloi në Gjimnazin “Silvira Tomazini” të Mitrovicës, në të cilën për nxënësit shqiptar ligjëronte dy lëndë, atë të fizikës dhe kimisë, ndërsa nxënësve serb u mbante vetëm lëndën e fizikës. Ligjërimi i lëndës së fizikës për nxënësit e paraleleve serbe ishte njëherë edhe befasi si për serb e po ashtu edhe për shqiptar sepse njëherë ishte edhe rast i parë në Kosovë. Në të njëjtën kohë në Shkollën e Mesme Teknike “Boris Kidriq” nxënësve serb aty këtu edhe ndonjë shqiptari që vijonin mësimet në gjuhën serbe për shkak mungesës së kuadrit shqiptar u mbante gjashtë lëndë profesionale të kimisë, ku paguhej me honorar. Po në këtë kohë lëndën e fizikës e mbante edhe në Shkollën e Mesme të Mjekësisë në Mitrovicë. Me hapjen e paraleleve të Shkollës Normale në Mitrovicë, u angazhua me tërë qenien e tij në përfshirjen sa më të madhe të nxënësve në këtë shkollë, duke përgatitur kuadro të reja për shkollat fillore jo vetëm për regjionin e Mitrovicës, por edhe më gjerë. Gjatë viteve 1961-1963, punoi si udhëheqës i ushtrimeve të kimisë, pranë Fakultetit Filozofik në Prishtinë. Njëkohësisht mbante edhe lëndët e kimisë në gjimnazin “Ivo Lolla Ribar”, të Prishtinës ku paguhej me honorar. Në periudhën 1963-1966, profesor Ahmet Maloku punoi pranë Entit Krahinor për përparimin e Arsimit në Prishtinë, si Këshilltar (inspektor) për lëndët kimi e fizikë për shkolla fillore (1963-1964), për të tri gjuhët (shqip, serbisht dhe turqisht). Pas diplomimit në fakultet emërohet Këshilltar Krahinor i Arsimit, për kimi dhe fizikë për të gjitha shkollat e mesme në të tri gjuhët për vitet 1964-65 dhe 66.

Gjatë vitit shkollor 1966-1967, ishte profesor në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prizren ku ligjëronte lëndën e kimisë inorganike në gjuhën serbokroate. Këtu në këtë shkollë profesor Ahmet Maloku duke e përdorur aftësinë, mençurin e para se gjithash guximin dhe trimërinë intelektuale bëri ndarjen sipas gjuhës mësimore. Me që në at kohë në këtë shkollë vijonin mësimet rreth 120 studentë prej të cilëve 45 ishin shqiptar të cilët nuk e zotëronin sa duhet gjuhën serbokroate, ai me mjeshtrin e mençurisë së tij arriti ta bind Demush Shalën (drejtor i SHLP) dhe Ismet Dehirin profesor i matematikës, (të cilin profesor Ahmeti shumë shpesh ma përmendke si shokë klase që kishin qenë me një sjellje dhe edukim të lartë familjar), që edhe pse ishin të paktë në krahasim me palën serbe ta qesin në diskutim problemin e bifurkacionit të grupeve në gjuhë serbishte dhe shqipe. Me këtë rast paraqitej nevoja e dyfishimit të orëve dhe shtimit të mësimit për nxënësve shqiptarë. Profesor Demush Shala dhe Ismet Dehiri nuk ishin për këtë mendim me çrrastë profesorit Ahmet i thonë se po ta qesim në diskutim këtë çështje me siguri se do të humbim në votime me që jemi pakicë ndaj shumicës serbe. Mirëpo profesor Ahmet Maloku ishte këmbëngulës në këtë drejtim dhe vendosi që ti shkojë deri në fund kësaj çështjeje, në të

cilën siç do të shohim, edhe kishte pas sukses. Në seancën e mbajtur, pala serbe nuk kishin votuar për bifurkacion me motiv se kinse nuk ka buxhet të mjaftueshëm për mbulesa financiare për dyfishimin e orëve. Pas abstenimit të palës serbe për të votuar për këtë lloj të bifurkacionit, menjëherë e kishte marrë fjalën profesor Ahmet Maloku dhe duke mos menduar fare për një rrezik që mund ti kanosej ai me mjeshtri trillon se kinse paska qenë në vizitë në Komitetin Krahinor dhe aty e paskan pyetur se si po shkojnë punët në SHLP?-mirë iu kishte thënë, dhe se në çfarë gjuhe po ju ligjëron shqiptarëve? Profesori duke vazhduar më tutje gjatë rrëfimeve të kujtimeve të veta më tregonte se u kishte thënë: “Shqiptarëve ju ligjërojë në gjuhën serbokroate, sepse për këtë më kanë pranuar dhe për këtë paguhem.” Ata gjoja i paskan thënë: “A e dini ju se shteti dhe shoqëria jonë ka të holla dhe duhet ta bëni ndarjen në baza gjuhësore sa më parë që të mos bini në pozita të forcave të errëta të cilat i kemi gjykuar në plenumin e Brionëve.” Dhe mu për këtë shokë u kishte thënë profesor Ahmeti të pranishmëve ne seancën e mbajtur, unë votoj për ndarje dhe barazi nacionale dhe nuk e lejojë veten që të bie në pozitën e forcave të errëta që u gjykuan në plenumin e Brionit. Kjo kërkesë kaloi në vota dhe pa diskutuar më askush të gjithë kishin votuar për ti formuar katedrat për të gjitha lëndët, edhe në gjuhën shqipe. Sipas profesor Ahmet Malokut pas dy vjetësh ishte bërë bifurkacioni edhe në fakultetet e Prishtinës, (kallëzuar me datën 8 prill 1995 e shtunë, Mitrovicë në shtëpinë e profesor Ahmet Malokut).

Gjatë viti shkollor 1967-1970, Ahmet Maloku punoi si drejtor i Shkollës së Mesme



Normale “Hasan Prishtina” në Mitrovicë, e në të njëjtën kohë mbante edhe ligjërata pranë Shkollës Lartë Teknike, në katedrën kimi-fizik, në të cilën i mbante lëndët: kimi inorganike, kimi organike dhe metodikën e kimisë. Gjatë viteve 1954-55, në Mitrovicë ishin hapur paralelet e para të shkollës Normale, të cilat funksiononin në kuadër të shkollës së mesme të Gjimnazit. Ndërsa pavarësimin e saj kjo shkollë e arriti në vitin 1967, me drejtor të parë të saj profesor Ahmet Malokun. Si erdhi deri te zgjedhja e profesorit të nderuar në detyrën e drejtorit të këtij institucioni pedagogjik, do ti shkoqitim disa kujtime të profesorit të atëhershëm të gjuhës shqipe Z. Ibrahim Bala, nga i cili nëpërmes një miku inxhinier Ramadan Ademi-t (aktivistit të pa kursyer të LDK-ës, si para lufte ne Kosovë e po ashtu edhe pas

Profesor Ibrahim Bala (1943-)

lufte me degën në Mitrovicë), arrita ti siguroi ca fjali në të cilat prof. Bala mes tjerash shkruan:

“Shkolla normale e pavarur ne Mitrovicë nuk ka ekzistuar gjer në vitet 1966|67. Kanë ekzistuar në Mitrovicë paralele të ndara të shkollës normale të Prishtinës prej vitit shkollor 1956|57 gjer me 1966. Sipas një udhëzimi të ish Këshillit Krahinor të Kosovës në qershor të vitit 1966 u vendos që shkolla normale të formohet edhe në Mitrovicë e cila do të përfshinte nxënës nga

Vushtrria, Skenderaj, Leposaviqi e vendet tjera. Ne atë kohe disa profesorë jepnin mësim ne gjimnaz dhe ne paralelet e normales, u interesuan kenë do ta emërojnë drejtor, u përqendruam në prof. Ahmet Malokun, i cili ne atë kohë ishte mësimdhënës i "Shkollës së Lartë Pedagogjike" kimi-fizikë në Prizren. Vendosiëm të shkojmë: Un (Ibrahim Bala), profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe, Ali Topalli profesor i fizikes, të ndjerët, Idriz Kosova profesor i pedagogjisë dhe Ismail Gubetini profesor i filozofisë. Në Prizren u takuam me Ahmet Malokun dhe pasi ia treguam qëllimin e ardhjes pranoj. Pas shpalljes së konkursit u emërua drejtor i Shkollës Normale ne Mitrovicë, po atë ditë un Ibrahim Bala propozova që kjo shkollë te quhet Shkolla Normale "Hasan Prishtina". Pas një viti pranë shkollës iu ngrit edhe busti i Hasan Prishtinës. Shkolla Normale "Hasan Prishtina" punoi gjer në vitin 1976|77 vetëm me disa paralele, ndërsa ne fund të Shkollës Normale "Hasan Prishtina" u themelua Shkolla e Mesme Ekonomike "Hasan Prishtina". Ketë emër e mori ne vitin 1992." , fundi i citatit të shkoqitur nga kujtimet e profesor Ibrahim Bala.

Të shtoj se gjatë bisedave dhe kontakteve të mija të shumta me profesor Ahmet Malokun, ai nuk më pati treguar në detaje mënyrën e zgjedhjes së tij për drejtor të shkollës Normale, përveç se më kujtohet që e zinte në gojë profesor Ibrahim Balën duke më thënë se ai kishte ardhur me disa koleg të tij në Prizren që të më bind të kthehem në Mitrovicë dhe ta marr detyrën e drejtorit të shkollës normale. Mirëpo shumë vite më vonë, saktësisht në vitin 2007, publicisti i njohur nga Mitrovica profesor Fazli Hajrizi tani drejtor i shkollës së mesme të Gjimnazit "Frang Bardhi" në Mitrovicë, të cilit sa banoja në Mitrovicë por edhe tani kohë pas kohe nga Prizreni ku jetoj me familje shumë shpesh i ofroja ndihmë në literaturë dhe informata nga të ndryshmet që i paraqitet nevoja, botoi librin monografik për shkollën normale "Hasan Prishtina" në Mitrovicë, në të cilën pata rast të lexoj shumë gjëra interesante e mes tjerash edhe shumë informata të cilat më parë mi kishte treguar i ndjeri profesor Ahmet Maloku, por shumë shpesh duke mos shkuar deri në fund të ngjarjeve. Mu në këtë libër hasa në mes tjerash edhe në emrin e profesor Ibrahim Balës, i cili i kishte rrëfyer autorit të librit kujtimet e veta për zgjedhjen e Ahmet Malokut drejtor të shkollës normale në Mitrovicë. Kjo qe motivi shtyrës i imi që të kontaktoj disi me profesor Ibrahim Balën në mënyrë që të kamë një informatë sa më të qartë rreth zgjedhjes së Ahmet Malokut drejtor të shkollës normale. Për këtë i falënderohem profesor Ibrahim Balë-s. Ndërsa të interesuarit më gjerësisht për këtë çështje le ti referohen librit të Fazli Hajrizit, Shkolla Normale "Hasan Prishtina" e Mitrovicës, Prishtinë 2007. Këtë libër mua ma dhuroi shoku im nga Mitrovica, mr. i shkencave kriminalistike, Saad R. Gashi, më 25 tetor 2007, enjte në shtëpinë e tij në Mitrovicë, ku një natë tetori të bukur isha mysafir i familjes së tij. Edhe Saadi edhe vëllai i tij Ubejdi kanë pas rast shpesh bashkë me mu të rrimë dhe të kuvendojmë me profesorin e nderuar Ahmet Maloku, por me sa e di ata nuk ishin aq të interesuar të shënojnë në fletore bisedat e zhvilluara, ndërsa unë kudo që shkoja mbaja me vete një fletore të vogël me laps apo kimik, që sado pak të zë ndonjë informatë prej kujtdo qoftë që ishte në interesin tim, apo si kthehesha në shtëpi menjëherë i hedhsha në letër at pjesë të cilën kamë mund me mbajt në mend. Këtu bëjmë një përjashtim nga se Saadi në korrik të vitit 1994, kishte marrë disa të dhëna nga Ahmet Maloku, për Qerim Klopën e Pantinës dhe Ramadan Rexhën e Mitrovicës, për ca ngjarje gjatë përfundimit të Luftës Dytë Botërore.

Pas një kohe të shkurtë të zgjedhjes në detyrën e drejtorit të shkollës profesor Ahmeti shkroi një shkrim për Hasan Prishtinën e cila u botua në dhjetë vazhdime në revistën "Zani i Rinisë", tetor 1967, shkurtë 1968. Tani duhet cekur se në librin, e IV-të me radhë të profesor Ahmet Maloku-t, "ENCIKLOPEDIKTH I VOGËL-politiko-etnologjiko-historike" botuar më 1998, në të cilën mes shkrimeve tjera interesante ai kishte shfrytëzuar rastin ta bëjë riprodhimin e fejttonit për Hasan Prishtinën, por tani me një lëshim, sepse vazhdimi i pestë me radhë i këtij fejttoni me titull "Një ditë historike në parlamentin otoman" nuk u përfshi në këtë libër

Me këtë rast më duhet të bëjë një digresion për ç'gjë lexuesve të nderuar u kërkoi falje. "Me datën, 6-IV-1998 e hënë, kur profesori ma solli në shtëpi librin e po sa botuar, dhe

ende pa ma dorëzuar në dorë, më tregoi për gabimin e lëshuar nga ana e botuesve, nga se e dinte që me siguri un do të reagoja në lidhje me këtë lëshim, sepse disa vite më parë ai mi kishte dhënë komplet numrat e kësaj reviste që ta bëja fotokopjen e këtij fejtani, si dhe më tregoi se në një vend të librit në fusnotë e cekë emrin tim në shenjë falënderimi për dhënien e shumë informatave dhe librave nga biblioteka ime, për tema të ndryshme e me këtë rast veçohet literatura për lëvizjen e masonerisë. Më poshtë i referohemi librit në fjalë në të cilën profesor Ahmet Maloku në fusnotën e saj i hedh ca fjalë falënderuese për mua:

... *“Bibliotekën më të pasur me literaturë të kësaj fushe (lexo për lëvizjen e masonerisë, pl. Sh. V.) e ka Shefki Voca (nipi i Sherif Vocës A. M.). Ky (Shefkiu) i lexon, i mëson dhe shton thesarin e kësaj literature, duke...i*



interpretuar si lypset. Edhe vetë kamë pasur ndikim në Shefki Vocën. Është mirënjohës për këtë, por edhe unë e falënderoj për dialogët e gjata dhe mikpritjen që ma bëri. Krejt librat që i ka gjithmonë m'i ka lënë në dispozicion. KY njohës i mirë i kësaj literature dhe zotërues i librave të tillë, është unikat në Kosovë... Vetëm Shefkiu më kupton kur unë e zbërthej ndonjë ngjarje në këtë temë...”

Profesor Ahmet Mloku sipas gjitha gjasave i kishte shkruar në brendësin e këtij libri këto fjalë, nga se kur e botoi librin e III-t të tij me radhë “Isa Boletini-integristi i parë i të gjitha trojeve etnike shqiptare”, në vitin 1997, ai këtë here nuk ma solli vet librin sikurse ato dy librat

Në foto drejtori Ahmet Maloku duke lexuar referatin me rastin e inaugurimit të bustit të “Hasan Prishtinës”

e para të tija, por ma kishte dërguar nëpërmes studentit të historisë Bedri Bala i cili tani është duke përgatitur magjistraturën në këtë shkencë. Me që, unë pak ca u hidhërova përse fare askund nuk më përmend mua, të paktën me ndonjë fjali falënderuese për ofrimin e literaturës si dhe informatave gojore, që me këtë rast kishin të bënin me lëvizjen masone dhe më pak me të tjera, atëherë unë e mora në telefon dhe me pak fjalë e kritikova duke i thënë: “Axha Ahmet ka qenë e udhës ta cekësh diku në hyrje të librit për ofrimin e literaturës dhe ca informatave tjera në lidhje me masonerinë që i ke marrë nga unë, sepse dhashë Zoti në të ardhmen edhe unë vet mëdoj që të publikoj aty këtu ndonjë shkrim, ashtu që nesër apo pasnesër mos me thënë lexuesit ja i ka marrë gjitha nga Ahmet Maloku, posaçërisht qytetarët e Mitrovicës të cilët shumë shpesh më shihnin në shoqëri me juve.” Ndërkaq që dy muaj më parë me datën 7 korrik 1997 e hënë, axha Ahmet erdh tek unë me djalin e dytë Naimin (inxhinier i elektroteknikës me aftësi të rralla), që të më njoftoj me te. Unë e njihja Naimin edhe ai mua, por nuk këmbenim biseda njeri me tjetrin. Andaj në praninë time axha Ahmet mua më prezantoi me fjalët më të mira që ekzistojnë. Mes tjerash i tha: “Naim, ky është Shefki Voca që të kam treguar shumë herë për te, ja a po ia sheh bibliotekën sa të pasur e ka, e sidomos me libra nga shoqëria sekrete e masonerisë, i cili vazhdimisht më furnizon dhe ma lënë tërë bibliotekën e tij në dispozicion. Në librin e

cila presim që së shpejti të dalë nga botimi (fjala është për librin e Isa B...) vazhdoi axha Ahmet duke i thënë Naimit, shumë më kanë ndihmuar literaturat që mi ka dhënë ky me çrrastë kamë bërë plotësime të duhura në te.” Atëherë Naimi i kërkoi nja dy apo tre nga titujt e librave që ti shoh më pranë veti. Atë ditë përveç bisedave rreth librit të tij ne, zhvilluam edhe biseda tjera aktuale politike. Andaj sipas gjitha gjasave për shkak reagimit tim për librin e Isa Bol...ai me rastin e botimit të librit të IV-të të tij i shkroi në brendësin e saj në faqe 32 siç po shihet edhe më lartë ca fjalë falënderuese për mua.

Punën e drejtorit të shkollës normale “Hasan Prishtina”, profesor Ahmeti e filloi me një dashuri dhe përkushtim të madh. Ai dëshironte që mësimmhënësit e kësaj shkolle të dallohen me çdo gjë nga kolegët e tyre nëpër shkolla tjera. Më kujtohet se më thoshte shpesh, unë dëshiroja që në shkollë para se gjithash të sundoj disiplina, morali, karakteri, ndërgjegjja dhe dinjiteti. Që tek profesorët të vërehet prezenca e një serioziteti të madh ndaj punës së tyre si pedagogë. Të respektohen parimet dhe qëndrimet e hierarkisë prej drejtorit e deri te shërbëtori, duke mos iu mohuar në asnjë mënyrë drejtat e nxënësve që u takojnë. Profesor Ahmeti bënte kontrollime të kohë pas kohë tek mësimmhënësit. Hynte nëpër orë të mësimit pa paralajmërim dhe u shtronte pyetje nxënësve, në momente nuk përtonte ti qortojë edhe mësimmhënësit për lëshimet dhe gabimet e tyre. Hallë në sy iu bë profesorëve të historisë dhe të gjuhës shqipe. Ca nga ata filluan të shprehin zili ndaj profesorit tani drejtorit të shkollës për shkak se shumë shpesh ju ndërhynte nëpër orë të mësimit dhe kërkonte shumë më shumë prej tyre. Më tregonte se si profesorëve të gjuhës shqipe ju thoshte, që më tepër ti jepni përparësi gramatikës dhe rregullave gjuhësore se sa



Fotografia me rastin e ditës së kremtimit të shkollës normale “Hasan Prishrina”. Në këtë kremtim morën pjesë shumë personalitete të njohura kombëtare siç ishin Mark Krasniqi, vëllezërit Fehmi e Hilmi Agani, Idriz Ajeti, Dervish Rozhaja, Ramiz Kelmendi, Enver Gjerçeku, Anton Çeta, Jusuf Ferizi (gazetar) , si dhe aty këtu ndonjë serb që për kohën ishte normale (prilli i vitit 1968).

jetës dhe biografisë së shkrimtarëve, me që kjo e dyta më letë mësohet dhe nuk kërkon shumë punë, ndërsa atyre të historisë që sa më shumë të potencohet historia e mirëfilltë e popullit shqiptarë, dhe autoktonia e tyre në Ballkan. Është interesant një detal në lidhje me këtë, kur profesor Ahmet Maloku i cili me të vërtetë ishte i rast me informata nga të ndryshmet, më tregoi se disa vjet para se të rrëzohej Aleksander Rankoviçiqi nga pushteti, ish ministri i punëve të brendshme në Jugosllavin Titoiste, gjakpirësi i shqiptarëve, kishte thirr në kabinetin e tij Millan Neroçicin kryetarin e rinisë së Jugosllavisë, që ta urdhëroi historianin Bogumil Hrabak, duke mos kursyer mjete materiale dhe duke ia plotësuar të gjitha kushtet e kërkuara vetëm e vetëm ta mohoj prejardhjen ilire të shqiptarëve, (informatë e dhënë më 17-VIII-1993, enjte mbrëma në shtëpinë e tij në Mitrovicë, dhe në praninë e shokut tim Mr. Saad Gashi. At natë na shpjegoi edhe ca gjëra në lidhje me politikën e ish kryetarit të Egjiptit, Naserit, i cili në gushtin e vitit 1966 i kishte ekzekutua disa persona të organizatës “Vëllezërit Mysliman të udhëhequr nga dijetari i fesë Islame Seejid Kutub). Pra me ndërhyrjet e tija Ahmet Maloku shumë shpesh i kalonte kufijtë e caktuara të plan programeve mësimore që sipas përtacëve dhe meskinëve (lexo disa profesorëve) ato vinin ndeshë me programin e ministrisë së arsimit. Qëllimi i tij ishte i qartë aftësimi dhe përgatitja sa më e gjerë profesionale e nxënësve, por deri diku pse jo edhe ajo e mësimdhënësve në lëmit e profesioneve të tyre. Ai caktonte shumë shpesh tubimin e mësimdhënësve ku debatohej për çështje dhe probleme të ndryshme eventuale të shkollës. Nuk lejonte assesi mungesën e profesorëve pa arsye të forta, por as të nxënësve dhe punëtorëve të shërbimeve civile që ishin në shërbim të shkollës. Andaj si duket kjo punë me një disiplinë, karakter, ndërgjegje të fortë si dhe pedagogji të mirëfilltë nuk i shkonte për shtati ca sahanlëpirësve dhe provincializmit të tyre meskin, të cilët me një ego të tërbuar, shpifnin dhe trillonin gjëra të pa qenë duke u ankuar tek njerëzit e pushtetit për kinse pa përgjegjësinë e një drejtori i cili paska kthyer shkollën si të ishte pronë e vete duke mos iu përgjigjur askujt për asgjë, duke i dënuar profesorët me heqjen nga pagat mujore pa asnjë arsye. Në këtë mënyrë për tu pasur motive sa më të shumta që të akuzohet e më pas të vjen edhe deri te shkarkimi i detyrës së drejtorit të shkollës Ahmet Maloku-t, njerëzit e komitetit në krye me ata të UDB-ës e përgatitën një komplot, në të cilën kishin angazhuar disa mësimdhënës shqiptar bashkë me një profesoreshë që drejtorin e shkollës Ahmet Maloku-n ta sulmojnë fizikisht në zyrën e vet. Këtë sulm e kishin marrë për obligim ta kryenin disa profesor në mesin e të cilëve ishte edhe një femër-profesoreshë, (për autorin e këtij shkrimi emrat dhe mbiemrat e sulmuesve janë të njohura, por me që jam duke e përgatitur një monografi në të cilën më hollësisht do të paraqiten detajet edhe më të imëta nga biografia dhe aktiviteti patriotik i profesor Ahmet Malokut, andaj me këtë rast nuk do t’i paraqes emrat e tyre). Sulmuesit, të mjerët na se çfarë “pedagog” kanë mund me qenë ata, që në biografinë e tyre e lanë një njollë të pa shlyer befasisht e sulmojnë profesorin në zyrën e tij të drejtorit. Por falë Zotit në ato momente shumë të pa përshtatshme për profesorin e nderuar, në shkollë shkon një mik i tij Ibrahim R. Voca (1938-1994) për ta vizituar. Me të hyr në zyrën e drejtorit miku i tij dhe kushëri i autorit të këtyre rreshtave duke parë tollovinë e krijuar, nuk banë as një as dy dhe në shpejtësi e nxjerr revolen pesëmbëdhjetëshe nga xhepi i brendshëm i setrës duke iu drejtuar atyre të cilët kush me thikë e kush me një varëse të teshave dhe me karrige në duar iu kishin vërsulur drejtorit duke e futur në qoshe të zyrës pranë dritares që në mënyrë fizike ti qërojnë hesapet me te. Por prapë falë mençurisë dhe inteligjencës së profesor Ahmetit, i cili shpejtë e kupton se kjo është organizuar dhe përgatitë nga

njerëzit e komitetit dhe të UDB-ës në bashkëpunim me këlyshit e tyre, e parandaloi at më të keqen. Sulmuesit me të parë personin me revole në dorë që po i del krah drejtorit, u frikuan deri në atë masë sa që nuk e pritën njeri tjetrin por me një shpejtësi si rrufeja ikën nga zyra e drejtorit. Ibrahim i ishte trim dhe shumë i vendosur (të paktën unë si kushëri i tij ashtu e kamë njohur pl. Sh. V.) i cili nuk zbrapset lehtë, tentoi të shkoj pas tyre dhe t'i qëroj tani ai vetë punët me ta, por falë mençurisë dhe urtësisë së drejtorit Ahmet Maloku situata e tensionuar ra në nivel. Mirëpo ky akses nuk u hesht edhe aq lehtë. Policia ia behu në shkollë, dhe i murrë që të gjithë në pyetje. Pas pak i lëshojnë që të gjithë, përveç Ibrahimit të cilin e mbajnë 24 orë për shkak revoles. Më pas e lëshojnë, sepse babai i tij Riza L. Voca (1904-1964), kishte qenë pjesë marrës i Lëvizjes Nacional Çlirimtare 1941-1945, si dhe pas luftës aktivist i partisë, ndërsa edhe nëna e Ibrahimit Sofija gjithashtu kishte kontribuar në këtë luftë me përgatitjen e ushqimit, thurjen e xhemperëve, çorapëve dhe të kapelave për luftëtarët e lëvizjes nacional çlirimtare. Ndërsa revolen të cilën vazhdimisht Ibrahim i bartte me vete kishte qenë i babait të tij Riza Voca, por pas vdekjes së këtij revolja me lejen e organeve të pushtetit i mbetet Ibrahimit si shenjë kujtimi të babait. Mbas këtij rasti, dhe pasi që e lirojnë Ibrahimin, organet përkatëse të pushtetit ia ndalin revolen. Por pas kërkesës së nënës së tij Sofijes, pas dy javë sërish ia kthejnë por tani vetëm me një kusht që mos me pas të drejtë me bartë me vete, (rrëfimet e Ibrahim Voca, më 3-prill-1993 e shtunë pasdite, në shtëpinë e djalit axhës tim ku pritnim mysafir për vdekjen e babës së tij Shaqir Sh. Vocë-s. Dy vjet e më tepër këtë informatë e mora edhe nga profesor Ahmet Maloku, me një rast kur ishte si shumë herëve tjera mysafir i imi, dhe në praninë e disa shokëve të mi, 10-IX-1995, e dielë pas darke). Kisha dëshirë që këtë ngjarje-akses ta dëgjoi edhe nga vetë rrëfimet e axhës Ahmet.

Profesori i nderuar nuk dëshironte që në asnjë mënyrë shkolla të cilën ai e udhëhiqte të jetë nën ndikimin e kujtqo qoftë nga organet e partisë në pushtet. Së pari manifestimin që e organizoi dhe mbajti në sallën e shkollës me rastin e emërimit të kësaj shkolle me emrin a patriotit dhe atdhetarit Hasan Prishtina, ai nuk u konsultua me askënd nga komiteti që aso kohe njerëzit e udhëheqjeve partiake pritnin dhe grinin çdo gjë, pastaj po në këtë sallë ai organizoi simpoziumin e parë për përvjetorin e vdekjes së Skënderbeut, në të cilën ai doli i pari me ligjëratat e pas tij profesori i historisë Sejdi Sylejmani. Gjithashtu vendosja e bustit të Hasan Prishtinës ishte mjaft punë delikate, me që për një kohë organizoheshin nxënësit dhe në mbrëmje mbanin roje që nga armiqët e kombit shqiptar mos të rrënohet, edhe pse përballë shkollës gjendej kazerma ushtarake në të cilën ushtarët si zakonisht rrinin në rroje. Nuk lejoi asnjëherë gjatë mandatit të tij si drejtor i shkollës që ndonjë person politik e administrativ jashtë sferës së arsimit të ndërhynte në punët e shkollës. Këtë e dëshmon edhe Kryetari i pleqësisë së shkollës, Bajram Elshani, i cili në Aktvendimin nr. 1524, të datës 17 shtator 1970, në lidhje me shkarkimin e drejtorit të shkollës shkruan: “Kryetari Kuvendit të Komunës në Mitrovicë, me vendimin nr. 01-4143, dt. 16 shtator, formoi komisionin, i cili kishte për detyrë me pa gjendjen dhe problemet në shkollë dhe për me dhënë raport për punën e vet. Komisioni ka ardhur në zyrën e drejtorit të Shkollës Normale “Hasan Prishtina” më dt. 16 shtator 1970, mirëpo drejtori nuk e ka pranuar dhe nuk ka lejuar që të kryejë detyrën e vetë.” (Fazli Hajrizi, libri cituar më lartë, faqe 421). Mirëpo të gjitha këto, e para se gjithash vendosë s'mërija, qëndrimi, trimëria dhe guximi intelektual i profesor Ahmet Malokut i pengonin ca punonjësve të arsimit në këtë shkollë të cilët kishin karakter dhe ndërgjegje tepër të dobët

me veprime të kundërta pedagogjike që nuk përtonin orë e qastë fshehurazi të bartin raporte të trilluara me plot shpifje për punën dhe aktivitetin e Ahmet Malokut në shkollë të cilat ai i ndërmerre pa dyshim në të mirë të shkollës, tek organet e komitetit dhe të UDB-ës, me një qëllim që sa më par të ndërmerret aksioni për shkarkimin e tij nga posti i drejtorit të kësaj shkolle, që pastaj ata të marrin frymë siç thuhet në popull “lirisht.”

Profesor Ahmet Maloku qëndroi në detyrën e drejtorit, pedagogut, dhe arsimdashësit të shkollës normale “Hasan Prishtina” deri në shtator të vitit 1970, kur edhe e shkarkuan. Mbledhjet maratonike të mbajtura një pas një me të njëjtën pikë të rendit të ditës që deri më atëherë asnjëherë nuk kishte ndodhur në asnjë vend të Jugosllavisë së Titos, me direktivat e Këshillit komunal bënë që drejtori i Shkollës normale Ahmet Maloku të shkarkohet nga ky post. Pra siç po shihet nga presione të një pas njëshme, dhe nga punët e liga të përgatitura prej dashakeqëve të çdo gjëje shqiptare që shkonte në favor të kombit tonë, qofshin shqiptar apo serb u mobilizuan që më në fund profesorin e nderuar dhe shumë të respektuar tek populli e sidomos të nxënësit e tij ta shkarkojnë dhe ta largojnë nga çdo lloj pune apo aktiviteti që mund të zhvillonte ai. Rrugë dalje tjetër nuk i mbeti përveç se të detyrohet dhe të japë dorëheqje pa pëlqimin e vet dhe të shumë të tjerëve. Atë nuk e larguan vetëm nga posti i drejtorit të shkollës, apo vetëm me ndërrimin e vendit të punës por, për një vit e më tepër e lanë tërësisht në rrugë pa kurrfarë të ardhurash, plus izolimi i shoqërisë dhe miqve të deri djeshëm të cilët s’kishin guxim t’i ofrohen me përshëndet e lere më që t’i bie ndërmend ndonjërit ti shkojë dhe ta vizitojë në shtëpi, nga frika e njerëzve të pushtetit, që sipas asaj që më tregonte profesori kjo e dyta ishte shumë më e rëndë se ajo e para. Por, më thoshte profesori i nderuar sidoqoftë o Shevki unë nga kjo që më ndodhi përfitova një përvojë të hidhur që në të ardhmen të di ta ndaj më mirë shapin nga sheqeri. Pra pas trysnive dhe presioneve të një pas njëshme drejtori dhe pedagogu i dalluar eksperti i shquar dhe i rrallë, profesor Ahmet Maloku u detyrua që me 17 shtator të vitit 1970, të shkarkohet nga detyra e drejtorit të shkollës së mesme normale të cilën ai me kënaqësi dhe ëndje e ushtronte dhe e donte. Përveç kësaj atë nuk e lanë të punoj as me honorar të mësimdhënësit të cilën krahas detyrës së drejtorit të shkollës e ushtronte në Shkollën e Lartë Teknike të Mitrovicës, në të cilën mbante ligjëratat në lëndët e kimisë inorganike, kimisë organike dhe metodikën e kimisë.

Shumicën e bisedave rreth biografisë së tij që për disa vite i zhvilloja me profesorin, duke më rrëfyer çdoherë nga diçka të re, unë vazhdimisht i shënoja në fletoren time të cilën e mbaj dhe e ruaj me kënaqësi të madhe. Atë fletore e kam regjistruar me emrin “Dosjet e profesor magjistër Ahmet Maloku”, dhe në të përveç të dhënave biografike gjenden edhe një mori të dhënash interesante nga biseda të ndryshme që i zhvilloja me të. Këto biseda shumë shpesh përcilleshin edhe me mospajtime, sepse ndodhte që për ngjarje dhe probleme të ndryshme qofshin politike, historike, letrare, filozofike, ndërkombëtare etj. të mos kemi mendime të njëjta. Dhe shumë nga ato pjesë biografike që mi pati rrëfyer për vete Z. Ahmet Maloku, pas vitit 1995 filloi dal ngadalë t’i botoi edhe nëpër libra të cilat një pas një u botuan duke filluar prej vitit 1996 e deri 1999. Me këtë rast më duhet të ceku se gjatë përgatitjes së këtij shkrimi kushtuar përvjetorit të lindjes dhe vdekjes së profesorit të nderuar, jam konsultuar edhe nga shënimet e mija të mara nga ai por, edhe nga konsultimi i librave të cilat i botoi më vonë. Këtu dua ta theksoj një detaj nga libri i tij i IV me radhë me titull: “ENCIKLOPEDIK I VOGËLTH-politiko-etnologjiko-historike” viti 1998, në faqe 108-109, në lidhje me përjashtimin nga detyra e drejtorit të shkollës normale “Hasan Prishtina”, përveç shkaqeve që i kam cekur unë nga vetë

rrëfimet e tija, tani do ta paraqesë këtu një detaj nga libri në fjalë në të cilën mes tjerash ai për vete shkruan: "...U përjashtova si person kundër partiak që kërkoja në diskutimet kushtetare, më 1969, që Kosova të ketë statusin Republikë, të ketë të drejtë për vetëvendosje dhe shkëputje, të jetë zonë gjuhësore shqipe në të gjitha fushat e jetës dhe të njihet e drejta që i takon KOMBIT dhe jo kombësisë, se këtë term e kanë shpikur pas Luftës së Parë Botërore racistët e quajtur demokratë të Luba Davidoviqit etj. Më tutje vazhdon profesori duke theksuar edhe këtë, u fajësua se kamë mbjellë nacionalizëm me fejtoret që i publikova më 1967, për Azem Bejtën, Hasan Prishtinën, Isa Boletinin dhe që shkrova artikull supërlativ, më 3 dhjetor 1967, për Sherif Vocën. Tani për përmendoren e ngritur të Azem Bejtës, e të Hasan Prishtinës, i kam ashpërsuar marrëdhëniet ndërnacionale."

Gazetari i "BORBA-s", M. Miliqi me datën 23 prill 1968 në faqe 4 të saj sjell artikullin me titull "ZBOG NACIONALISTICKIH ISPADA DIREKTOR UCITELJSKE SKOLE ISKLJUCEN IZ S.K", Ahmet Maloku pripada grupi tvoraca ideje o kosovskoj republici. (PËR SHKAK TË BINDJEVE NACIONALE DREJTORI I SHKOLLËS NORMALE PËRJASHTOHET NGA L.K" dhe më poshtë vazhdon: "Ahmet Maloku i takon grupit të themeluesve të idesë për Republikën e Kosovës."

Një vit pas përjashtimit nga puna, dhe pa kurrfarë mbetjesh ekzistenciale familjare, me mundime dhe angazhime të mëdha falë aftësive dhe diturive të tija shkencore u punësua në Entin për kërkime dhe zhvillime të Kombinatit të Obiliqit, si analitik përgjegjës për nikel, boksit, thëngjill dhe si themelues i shërbimit të korrozionit dhe hulumtuesit. Këtë detyrë e ushtroi prej viti 1971-1979. Ndërsa gjatë viteve 1979-1990, i kaloi duke punuar në Termocentralin "Kosova-A", për pesë fazat, shef përgjegjës i shërbimit për ujëra, thëngjill e gaze, ku përfshihej Batllava, Prugovci, përgatitja kimike e ujit, laboratorit, elektroliza etj. Në fund të vitit 1990 (17 dhjetor), pas 38 vjet pune u përjashtua nga ana e serbo-çetnikut Petar Kostić edhe nga kjo detyrë, e njëkohësisht edhe nga puna tërësisht. Arsyeja e përjashtimit nga puna herën e fundit ishte se më 3 shtator ka organizuar grevën dhe nuk ka lejuar fillimin e punës të fazës së IV...etj.

Profesor Ahmet Maloku është autorë i shumë shkrimeve. Ai deri në vitin 1970 botoi punime të ndryshme shkencore dhe publicistike nëpër gazeta dhe revista të kohës. Por që nga përjashtimi nga LK dhe largimi nga puna e drejtorit të shkollës normale atij më askund nuk i publikoheshin shkrimet, përkundër faktit që ai vazhdimisht shkruante artikuj të ndryshëm, ku më së shumti kritikonte ca historianë, gjuhëtarë, gazetarë, shkrimtarë, politikanë udhëheqës të ndryshëm dhe analistë politik. Kjo punë e bllokimit të shkrimeve të tija vazhdoi edhe pas rënies së sistemit monisto-komuniste. Këtu duhet bërë një përjashtim me që pas një kohe bukur të gjatë të bojkotimit dhe të izolimit të çdo gjëje që vinte nga penda e dorës së dikur shumë të njohur profesor Ahmet Malokut, më në fund dikujt i ra ndërmend që të paktën ta vizitoj në shtëpi dhe të shkoqit aq sa mundet ndonjë informatë apo analizë politike ditore nga dituria e tij e gjerë. Kjo ngjau kur më datën 4 prill, 1995, gazeta e atëhershme "BUJKU" botoi një intervistë të shkurtë me profesorin Ahmet Maloku në banesën e tij. Disa ditë para botimit të kësaj interviste axha Ahmet më lajmëroi nga Prishtina me telefon duke më thënë: "Shevki mos haro këto ditë përcjelle gazetën ditore "BUJKU" (duke më kërkuar falje sepse e dinte që unë rregullisht e lexoja të vetmen të përditshmen tonë atëherë), sepse si duket do të thyhej ajo monotoni e gjatë e bllokadës së shtypit ndaj meje." Unë e pyeta në lidhje me çka është fjala? Me atë rast më tregoi se para ca dite e kishte vizituar publicisti dhe gazetari i njohur, (tani më edhe ai i

ndjerë SH. V.) Mehmet Kajtazi i cili kishte zhvillu një intervistë bukur të gjatë me profesorin. Por nga ajo intervistë aq e gjatë (sipas fjalëve të profesor Ahmetit) gazeta e botoi vetëm një pjesë. Sidoqoftë edhe pse ishte shkurtuar goxha shumë, ajo qe mjaftë interesante, në të cilën profesori i kishte rrëfyer ca detaje nga kujtimet e veta si dhe nga pak për shkrimet me të cilat kohëve të fundit ishte duke e kaluar kohën. Titulli i kësaj interviste ishte “Ç’flet mësuesi i Adem Demaqit”. Ndërsa pas dy muaj gazeta e njëjtë ia botoi një material-reagim me titull “Kush ishte në të vërtetë Mehmet Shehu”. Ky shkrim ishte një reagim ndaj një fejtani të botuar afër dy muaj më parë të cilën e kishte shkruar djali i Mehmet Shehut, -Bashkim Shehu. Profesor Ahmeti nuk ishte i kënaqur me botimin e këtij reagimi të tij sepse atëherë më tregoi se e kishin recensuar tepër shumë. Këtë shkrim në tërësi më vonë e botoi në librin e vet publicistik “Ata gabo unë qorto I”, Prishtinë, 1996 faqe 29-38. Më kujtohet se pas këtij shkrimi tepër të censuruar më pati thënë: “Kurë më në asnjë mënyrë nuk do të pranojë të jap ndonjë intervistë, por as ndonjë shkrim për botim nuk do të dërgoi. Përkundër faktit se disa nga gazetarët që deri dje e kishin siç thotë populli lëçit iu lajmëroheshin me telefon që sipas mundësisë tu dërgoi ndonjë nga materialet e tija. Ai vazhdoi më pas dhe më tha: “Të gjitha këto që po i shkruaj dashtë Zoti do ti botojë në libra të veçanta.”

Dhe ashtu edhe ndodhi, sepse ai deri para vdekjes më 23 tetor 1999, botoi në vazhdimësi disa libra. Hovin e madh të shkrimeve ia ndali lufta, ndërsa si duket edhe mërzia e bëri të veten, sepse shpejt u sëmurë dhe pas një kohe të shkurtë edhe vdiq.

SI U NJOHA ME PROF. MR. AHMET MALOKU-në

Me 6. shtator të vitit 1988, në Mitrovicë në moshën 73 vjeçare ndërroi jetë Jashar Beqir Voca (1915-1988), axha i babait tim Shaban Voces. Jashar Voca, të cilin ne të familjes e quanim Bali Jashar ka qenë një plak i cili gëzonte respekt dhe autoritet jo vetëm ne familjen e madhe të Vocave të Mitrovicës, por edhe më gjerë. Ne shkurtin e vitit 1945, ai bashkë me gjashtë patriot e atdhetar, secili më trim dhe më i vendosur se tjetri në mesin e të cilëve ishin dy vëllezërit e tij (nga baba) më të mëdhenj Adem dhe Etem Voca, ky i dyti me gjithë djalin e vet të dytë nga pesë sa i kishte, Tahirin 16 vjeçar, pastaj nipi i tyre (djali motrës) nga fshati Zasell, Abdulla Lahi si dhe dy shokë shumë besnik dhe të pa ndarë të Adem Voces, Mon Ahmet Ferizi dhe Ferati i Cenit nga Stan Trgu (këta dy kushëri të parë mes veti pl. Sh. V.) ishin barrikaduar ne fshatin Pasomë tani Suma, ne kullën e tyre personale duke luftuar me njësitet partizane-çetnike, serbo malazeze, me ç’rast kishin bërë një rezistencë derri atëherë të pa parë, duke i shkaktuar armikut me dhjetëra apo qindra të vrarë dhe të plagosur. Lufta kishte zgjat rreth 36 orë, me humbje të mëdha të njësiteve ushtarake partizane çetnike, ndërsa nga ana tjetër mbijetoi vetëm Jashari i cili kishte marrë katër plagë ne trup. Fati deshi që ti shpëtoi dënimeve ma te ashpra, pushkatimit apo burgosjeve nga ma te rëndat siç vepronin komunistet e Titos aso kohe. Jashari deri në fund të jetës ishte në shënjestrën dhe përcjelljen e organeve policore jugosllave. Me aq forcë sa pati qëndroi dhe rriti shumë jetimë të cilët asnjëherë dhe në asnjë mënyrë nuk i dalloj prej fëmijëve të vetë. Gjatë jetës deri pak para vdekjes kur u sëmur, ai vazhdoi rrugën e babait të vet Beqir Musli Voca (1841-1925) duke marr pjesë në pajtimet e gjaqeve dhe ngatërresave të ndryshme, jo vetëm në Shalën e Bajgores, Drenicës, Llapit, Ortakollit, Prekorupës, Anamoravës, por edhe kah Rrafshi i Dukagjinit duke përfshirë edhe viset e Hasit, Gorës dhe Opojës, në të

cilat vazhdimisht arrinte sukses, andaj edhe kur vdiq atij iu bë një pamje madhështore e cila zgjati rrumbullak një muaj. Për luftën e Sumes dashtë Zoti do të shkruaj me një rast tjetër më tepër dhe më në detaje, sepse nga historianët dhe historiografia jon krejt pak ose aspak nuk janë përmendë këta trima atdhetar e patriotë të cilët e flijuan veten, vetëm pse nuk u pajtuan me premtimet e Fadil Hoxhës, Ali Shukriut, Rasim Qerkezit, Milija Kovaçevićit dhe vëllezërve tjerë të tyre serbo-malazez, që ti dorëzojnë armët dhe të dorëzohen se nuk do të pësojnë dënime. Përkundër faktit se Adem Voca më 25 dhe 26 janar të vitit 1945, u printe rreth 2000 luftëtarëve shaljanë në rezistencën e luftës e cila u zhvillua në Stan Trg, me ç'rast forcat partizane çetnike u zbrapsën duke u tërhequr deri në Mitrovicë tek varet e serbeve pranë fshatit Shupkocë. Me këtë rast për hir të objektivitetit dhe realitetit historik më duhet të ceku se në këtë luftë mjaftë të ashpër Adem Voca nuk është plagosur siç mund të hasim aty këtu në ndonjë shkrim. Mirëpo, Ademi duke mos iu zënë besë këtyre të pa besëve sepse, sikur që kishte thënë edhe vetë se nuk ekzistojnë kurrfarë kushte që të lidhemi për fjalët e tyre, e kishte parasysht faktin se pushteti sllavo komunist i cili çdo ditë e më tepër vinte duke u forcuar, njerëzit e të cilëve për çdo natë me urdhër kinse nga lart hynin natën nëpër shtëpi duke i mbledhur burrat e pafajshëm të cilëve më nuk ju gjendeshin askund gjurmët. Njerëzit vriteshin dhe pushkatoheshin brenda nate pa kurrfarë gjyqe, duke mos ditur më asgjë për fatin e tyre. Andaj, Adem Voca duke mos dashtë me marr masën e gjerë të popullit në qafë vendos që vetë i shtati të tërhiqet dhe të qëndroi në kullën e tij dhe pa pranuar kurrfarë kompromisi vazhdoi luftën kundër njësiteve partizane çetnike duke udhëheq një luftë shumë fish të pa barabartë, deri në plumbat e fundit kur edhe ra heroikisht si i ka hije burrave trima shqiptar. Derisa këta trima luftonin kundër armikut të përbetuar të shqiptarëve, gratë fëmijët dhe nipat e tyre, të vegjël që kishte aso edhe në djep ishin vendosur në podrumet e kullës, prej nga herë pas here gratë u dërgonin ndonjë copë bukë sa për ta mbajtur shpirtin, sepse diç tjetër as që kishte pas kohë për të ngrënë. Kësaj katrahure deshi Zoti i Madhërishtëm që ti shpëtoi vetëm Jashari të cilin e cekëm më lartë duke i marrë katër plagë në trup.

Gjatë kohës sa zgjati e pamja në shtëpinë e të ndjerit Jashar Voca, e cila gjendej në qendrën e qytetit të Mitrovicës të cilën e kishte ble Sherif Beqir Voca në vitin 1934, nga vëllai i Xhafer Devës, Riza Deva, (në luftën e fundit 1999, ajo shtëpi me disa tjera për rreth u kallën deri në themel nga barbarët sebo-çetnik) ndër shërbëtorët kryesor që u bënte hyzmet siç thuhet në gjuhën popullore mysafirëve që pa ndërpre vinin në të pamë ishte autori i këtyre rreshtave me kushëririn e vet nga fshati Melenicë e Shalës, Fadil Jetulla Voca. Këtu pata rastin e veçantë të jetës time, të njoftohem me njerëz të urtë dhe pleqnar të vendeve të ndryshme. Me këtë rast do ti cekim ca pleqnar të njohur, si për shembull: Hysen Ramë Lutani nga Turiqevci i Drenicës, Mujë Loshi nga Padalishta i cili dallohej prej të tjerëve ndaj një respekti të veçantë që kishte për familjen Voca, Hysen Reci nga Llausha një plak tepër i mençur, Hamdi Kqiqi, Tahir Maqastena, Ilaz R. Kolla, Sadik Zeneli i familjes së pleqnarit me famë Xhemajl Obrija, Sherif Dedinja, Brahim Kurti, i cili sipas informatave që i kam deri sa po i shkruaj këto rreshta (mesi i korrikut, 2009) jeton ende por nuk ka mundësi të merr pjesë nëpër pajtime sepse është i sëmur, dhe është plakur mjaft, si dhe shumë e shumë pleqnar tjerë të njohur. Përveç njerëzve të rëndomtë dhe pleqnarëve të cilët i ceka që vinin në pamje ishte edhe një numër i madh i klerikëve fetar dhe intelektualëve të ndryshëm nga të gjitha anët e Kosovës të cilët kishin pas rast të rrinë dhe ti dëgjojnë fjalët e urta të ndjerit Jashar Beqir Voca.

Dera për mysafir hapej në ora 8 të mëngjesit dhe zgjaste deri vonë në mbrëmje. Një ditë më ndodhi që të shkoj pak më vonë si zakonisht që shkoja. Ishte diku rreth orës 11. Me të hyrë brenda, për mua nuk kishte nevojë që të përshëndetem me njerëz që kishin ardhur me pa, por si zakonisht e mërsha rolin e shërbyesit në shpërndarjen e çajit, kafes, apo ndonjë gote me ujë varësisht kush çka pinte, si dhe në pastrimin e shpuzoreve të duhanit, ndërsa cigaret i shpërndanin burrat tanë që i pritnin mysafirët brenda në odë. At ditë kishte ardhur me pa një person që për nga pamja fizike për mua ishte i pa njohur, të cilin e shoqëronin disa vetë. Tani më e vëreja se dita e sodit dallohej nga ato ditë të tjera. Në odën e pritjes dominonte një qetësi e madhe që përcillej me fjalët të cilat i fliste ai. Të gjithë të pranishmit qofshin të huaj, qofshim ne të familjes e dëgjonim me vëmendje. Veshja e tij dallohej nga veshja e atyre pleqve që i kam cekë më lartë. Në trup kishte të veshur tesha kat me një kravatë dhe këmbë të bukur plot elegancë dhe pedanteri, ndërsa në kokë nuk kishte asnjë lloj kapele. Qëndrimi dhe të ulurit e tij ndryshonin prej të tjerëve, duhan nuk thithte dhe ashpër i qortonte të tjerët për këtë çështje, vëreja se askush nuk ia kthente fjalën. Nja tre pleqnar që ishin bë thuaja pjesë përbërëse e familjes tonë në pritjen dhe përcjelljen e mysafirëve nuk flisnin asgjë. Ndonjëherë aty këtu dëgjoja që dikush nga të pranishmit të thotë: “Rrofsh o profesor se na kënaq”. Atij i shtronin pyetje nga të ndryshme, në të cilat nuk mbetej pa u përgjigjur. Unë fillova të mahnitem me dijen dhe informimin e tij aq të rast. Ky burrë (që sipas meje kishte një autoritet të veçantë) qëndroi më tepër se zakonisht që rrihet në pamje. Pas shkuarjes së tij e kuptova se ai ishte profesor magjistër Ahmet Maloku, emrin e të cilit kisha pas rast ta dëgjoj shumë herë, por që fizikisht nuk e kisha par dhe njohur asnjëherë më parë.

Mbas dy dite profesori i nderuar erdh sërish me pa, por tani ishte pasdite dhe ne nuk rinim brenda në odë sepse ishte një kohë shumë e bukur shtatori ku nxehte një diell po thuaj si në muajin maj, andaj familjarët e kishin improvizuar një çardak në oborrin e shtëpisë shtruar me shilte në të katër anët e saj, tani mysafirët si të huaj e po ashtu edhe të afërmit që vinin në paradreken e çdo dite, në kohën e pasdites rralloheshin. Unë i afrova një kushëriri tim më te vjetër Ibrahim Riza Voca, për të cilin kemi bë fjalë më lartë dhe duke mos më vërejtur askush nga të pranishmit e pyeta me zë shumë të ulët pranë veshit të tij: “Axha Ibrahim pasi që nuk ka kallaballëk dhe numri i mysafirëve të huaj ishte i vogël a më lejoni që edhe unë me pyet diçka profesorin e nderuar?” Përgjigjja e tij ishte pozitive: “Po more qysh jo.” Dhe nuk priti as një as dy por iu drejtua me emër:” O Ahmet qy ky djalë ngatë meje po ka qef me të vet diçka (Ibrahimi ani se ishte shumë më i ri se profesori atij iu drejtohej me emër dhe e fliste gjuhën e odës), a po pranon ajo? Po more qysh jo me gjithë dëshirë, por para se të ma shtroi pyetjen më tregoni kush është ky, i kujt është, dhe çka po ju bie juve,? Ishin këto fjalët e profesorit Ahmet.

Pas prezantimit tim, ai së pari i foli disa fjalë rreth babait tim Shaban Sherif Voca (i lindur më 1927, në ndonjë dokument figuron edhe viti 1926, por baba vetë më thoshte se viti i saktë i lindjes së tij është 1927, vdes më 30 qershor 1976, plotësim Sh. V.) duke ju thënë të pranishmëve: “Vallahi bre juve Vocave të tjerë mos të ju mbetet hatri se ma i mençmi dhe ma i lexueshmi prej ju ka qenë Shabani. Atij shkit herët ja kurdisën akuzën për Informbyro, për asgjë tjetër vetëm pse ishte shumë mendje preftë. Dhe me sa e di Shabani ka qenë njëri nga të burgosurit e grupit të parë të Informbyrosë në burgun e ishullit Goli Otok, dhe prej më të rinjve. Nuk më kujtohet sa ka qëndrua atje por e di se kishte vuajt mjaft. Unë ndërhyra duke i thënë gjithsejtë gjashtëmbëdhjetë muaj ka ndejë i dënuar politikisht në ishullin e burgut të Goli Otokut. Profesorit i erdhi mirë kjo

informatë e imja dhe tha rrofsh, është mrekulli kur njeriu e njeh historinë e së kaluarës së familjes, dhe vazhdoi edhe me ca fjalë tjera të na tregoi për burgun famë keqe të Goli Otokut. Gjatë kohës sa fliste, unë mendoja në vete, çudi e madhe si është e mundur të di kështu saktësisht me emra të gjeneralëve të burgosur dhe politikanëve të tjerë, si dhe kur kishte filluar të ndërtohet ai burg famëkeq dhe me çfarë lloj materiali. Pastaj profesori i nderuar tha se atë burg regjimi Jugosllav në krye me Titon e kanë ndërtua vetëm për të burgosurit politik, por gjatë kalimit të kohës ajo e humbi rolin e vetë, sepse atje tani për vuajtjen e dënimit filluan ti dërgojnë edhe njerëz me vepra jo politike si për shembull kriminel dhe hajna të ndryshëm. Këto fjalë të profesorit shumë vite më vonë mi kanë vërtetuar edhe dy të ish burgosurit politik të Informbyrosë nga Mitrovica, Qemajl Jakub Kpuzi (1925-1997), informatë më 23. XII-1991, e hënë, dhe Abdulla Zejnulla Kabashi (1924-1997) informatë e dhënë më 12. III-1992, enjte. Këta dy kishin vuajt dënimin e burgut në Goli Otok gjatë viteve pesëdhjeta (1953), por nuk kishin qëndruar gjatë.

Pastaj profesori i nderuar mu drejtua mua dhe më tha mundesh me vazhdua me at që po të intereson.

Unë profesorit iu drejtova me axha Ahmet, dhe pyetjen si dhe biseda tjera që at ditë unë i zhvillova me te më duket se edhe tek të tjerët zgjoi një interesim të madh.

I thash axha Ahmet do ta shtroi një pyetje në lidhje me fiset tona shqiptare, për të cilat ju atë ditë kur erdhët në pamje i zutë mjaftë në gojë, ndërsa po e vërej që edhe sot shpesh i përmendni. Sa pata mundësi të dëgjoj prej juve, me që unë kur ju ishit herën e parë para ca dite këtu më tepër isha në lëvizje duke shërbyer, folët mjaft për fise dhe mund të ndodhë që nuk kamë kuptuar mirë. Gati cilin do qoftë person që ishte aty prezent kur e pyetnit nga jeni, pas prezantimit të personit ju menjëherë i tregonit se cilit fis apo bajrak i takonte si dhe nëse fshati prej nga vinte ai person kishte ndonjë mëhallë të përzier ju edhe ato i tregonit. Mua më fascinojë ajo informatë e mrekullueshme e juaja për njohurit që i kishit, jo vetëm për fise por edhe për shumë e shumë gjëra tjera, andaj për fillim më intereson të dëgjoj mirë dhe qartë nga ju se në sa fise ndahet populli shqiptar? Meqë kam pas rast të dëgjoj nga një far Shaban Dolaku me të cilin punoja në Zveqan, tani ai ka dal në pension, por ishte një plak mjaft i urtë, punën fort nuk ja donte zemra me siguri se ishte mjaft i shtyrë në moshë dhe se serbët nuk i donte ama bash hiq. Ai na tregonte shpesh gjëra interesante për traditat tona shqiptare si dhe për luftën e Shaban Polluzhës, në të cilën kishte marr pjesë edhe vetë si në Drenicë e po ashtu edhe në Novi Pazar në mbrojtjen e boshnjakëve nga sulmet çetnike. Baca Shaban me një rast na tha: “Eh de, po, po, neve shqiptarëve na kanë marrë 27 pushkë e na hala po rrimë n’komë tona.” Pas këtyre fjalëve u ndal, e hoqi plisin dhe me dorën e majtë e fërkoji nja dy herë kokën, dhe sërish e vuri plisin në kokë dhe nuk vazhdoi të flasë. Unë nuk e kuptova andaj i thash vazhdo baca Shaban sqaroma këtë çështje se vallahi nuk kuptova asgjë? Ai mu përgjigj me gjuhën që e fliste dhe unë ashtu në origjinale po e shkruaj. Ngo knejna o sheherli se ju nga shehri nuk i dini kto pun, thash 27 pushkë se na shqiptart jemi nda në 12 fise e 12 tarikate, a po bojn 24, ia ktheva me po, pastaj vazhdoi edhe tri fe, a bojnë krejt 27 . Po, me matematikë nuk e luanë, ia ktheva unë. Me këtë sikur donte të thoshte se ne shqiptarët jemi shumë të përçarë. Tani nga ju axha Ahmet kërkoi të di se cila është e vërteta për fiset tona, jemi 12 fise apo 7, siç pata rastin të dëgjoj disa herë nga ju.

“Shevki, mu drejtua axha Ahmet, ti qenke pak i ri dhe nuk paske pasur mundësi me i përcjellë shkrimet e mija që i kam botuar në lidhje me historinë e fiseve tona në vitet e gjashtëdhjeta. Sipas pleqve të anës së Gjakovës dhe atyre të Pejës ne ndahemi në

dymbëdhjetë fise, ndërsa dr. Atanasije Urosheviqi një studiues dhe hulumtues serb gjatë shkrimeve të tija na numëron në shtatëmbëdhjetë fise. Ndërkaq e vërteta sipas hulumtimeve të mija shumë vjeçare të cilat i kamë gjurmuar dhe hulumtuar nëpër fshatra të ndryshme të Kosovës i sjelli në shtatë fise.” Mirëpo axha Ahmet para se ti ceku emrat e fiseve ai mi sqaroi disa karakteristika që ndërlidhen me numrin shtatë, që për mua kjo nuk zinte aq peshë, por si do qoftë e dëgjova dhe nuk e lodha kokën që ti mbaja gjitha ato karakteristika të numrit shtatë në mendje, me që unë mezi pritja të filloi me shpjegimin e fiseve tona. Me gjithat ai e filloi bisedën kështu: Shevki në popullin tonë numri shtatë përdoret për shumë raste si për shembull: shtatë kralat (këtu më duket se aludohet për shtatë fuqitë e mëdha të gjysmës së dytë të shekullit 19-të, Anglia, Gjermania, Italia, Franca, Rusia, Austrohungaria dhe Perandoria Osmane, pl. Sh. V.); të Shtatë Shaljanët; shtatë sahat larg; shtatë pushkë të rrafshin, të përvëlloshin, të shitofshin të zanofshin, të shtatë fiset, të shtatë bajraçet e të tjera...Kurse sa i përket fiseve në realitet ekzistojnë këto: Shala, Berisha, Thaqi, Hoti, Kelmendi, Gashi dhe Krasniqi. Më pas vazhdoi dhe tha: Njëfarë A. Jovanoviq i cili është marrë me hulumtimin e fiseve shqiptare gabon kur në punimin e tij “Malesija” të cilën e boton në librin e 10, “Naselje i poreklo stanovnistva” (Vendbanimet dhe prejardhja e popullsisë), botua në Beograd në vitin 1913, edhe Kastratin e konsideron si fis. Gjithashtu edhe një serb tjetër Toma Oraovac, në librin e tij “Arbanasko pitanje i srpsko pravo” (Çështja shqiptare dhe drejta serbe-këtë libër shumë vite më vonë e porosita nga Beogradi, pl. Sh. V.), botua po ashtu në Beograd në vitin 1913, bënë gabim të madh kur thotë se edhe Isniqi është fis.” Axha Ahmet në këtë drejtim gjithashtu ia adresoi ca kritika edhe albanologut të madh kroat Millan Shufflaj për të cilin tha: “Edhe ky gabon kur mendon se Shkreli është fis.” Pastaj axha Ahmet në vazhdim më tha: “Shumë kush gabon kur mendon se Kabashi, Kryeziu, Shkreli, Bytyqi, Mziu, Kastrati, Drushtini, Merturi dhe disa të tjerë janë fise. Këto më tha janë barqe apo si i thonë edhe ndryshe vëllazëri të atyre fiseve që i përmendëm më parë.” Ai më pas më pyeti a thua do ti mbanë në mend gjitha këto që ti tregova dhe a të vazhdoi ende? Me këtë sikur ma hapi rrugën që të nxjerri lapsin dhe një bllok të vogël nga xhepi dhe ti kërkoi leje për evidentimin e këtyre çështjeve, për çka me pa dyshim ai edhe më lejojë, duke më thënë: “ Po more si jo, unë të diktoj ti shkruaj,” dhe asnjëherë nuk mundem të harrojë kur më tha: “Kështu dikur edhe vetë kamë vepruar” , që nënkupton se ka mbledh dhe grumbulluar shënime.

Pas kësaj axha Ahmet duke më diktua me një profesionalizëm të vërtet të një pedagogu të përvojës së madhe më tha: Fillojmë me fisin **Thaq** që ndryshe i thonë edhe Helshan, e cila ndahet në këto vëllazëri apo barqe: “Bytyç, Kabash, Sop, apo Morinë, Kryezi, Mzez, (Drushtinë), Mazrekaj, Zogaj, Korb dhe Shkrel.”

Fisi **Kelmend** ndahet në këto vëllazëri: “Lajçi, Muriqi, Nikqi, Dreshajt, Xhevukajt, Bogajt, Hoxhajt, Vukli, Vuthaj dhe Selçaj.”

Fisi **Hot** ndahet në gjashtë vëllazëri. Këta në fillim bashkërisht kanë zanë vend në fshatin Plluzhinë, ndërsa më vonë aty mbetet vetëm një vëlla, kurse të tjerët shpërngulen në Likovc, Ticë Tushillë, Morinë të Drenicës, dhe në Bradash të Llapit.

Shala ndahet në këta vëllazëri: “Gimë, Pecë, Maletë (ose Lotaj) dhe Lopç. Shalës i mbathet edhe një degë që quhet Shoshi.”

Berisha ndahet në këta vëllazëri: “Merturi, Alshiqi, Kuqi, Buzë-Madhja, Kastrati dhe vetë Berisha si vëllai më i madh.”

Fisi **Gash**, ndahet në Gashin e Gurit (ndryshe njihet edhe me këto emra: Gashi i Gurit të Bardhë i Bardhanë ose Gashi i Bardhë) dhe Gashi i Xërxës.

Dhe fisi i shtatë njëherë edhe i fundit sipas konstatimeve të mija vazhdoi axha Ahmet është **Krasniqi**, i cili ndahet në degën kryesore Krasniq, Nikaj, Mripa, dhe Curaj. Nikajt e kanë bajrakun e vet dhe numërohen si fis në veti, megjithëqë janë Krasniq. Pra Nikaj, Mripa dhe Curaj janë vëllazëri të Krasniqit.”

Pasi e përfundoi me sqarimin e fiseve nuk nguroi dhe më tha: “Tani mbylle bllokun dhe bashkë me lapsin fute në xhep, sepse tash do të vazhdoj të ju tregoi edhe shtrirjen e këtyre fiseve në të katër anët e fshatrave të Kosovës, me ç’rast mu drejtua me arsyen se nuk mundem më shumë me të diktua sepse na merë shumë kohë, dhe vendi nuk është bash i përshtatshëm për shkak të ndërprerjes së bisedës me që aty këtu po vinë ende njerëzit me pa, ndërsa ti do të vish një ditë në shtëpinë time bashkë me Ibrahimin apo mundesh lirisht edhe vetë, dhe unë do ti gjej shkrimet ku kanë qenë këto të botuara që ti huazoj deri sa ti i fotokopjon ose i shënon në fletoren tënde të shënimeve, dhe pastaj sërish mi kthen pas.” Për këto informata iu falënderova nga zemra, dhe pastaj filloi me sqarimin dhe tregimin e shtrirjes së fiseve nëpër gjitha anët e Kosovës. Nuk mundesha me marr me mend se ai njeri ka një memorie të jashtëzakonshme. Përveç emrave të fshatrave ai tregonte edhe bajraquet e tyre, pastaj ndarjet që kanë ndodhë gjatë historisë për shkaqe të ndryshme e më së shumti nga vrasjet dhe konfliktet mes veti, që kanë sjellë deri te shpërngulja prej një fshati në tjetrën, pastaj për takëmet e fiseve e shumë e shumë gjëra tjera që për mua ato si dhe temat tjera që i shpjegonte ishin tepër joshëse.

Mbas këtij rasti mua pastaj më binte më rrallë të takohem me profesor Ahmetin. Kur takoheshim në rrugë i nderonim tre katër fjalë. Atij më tepër i interesonte të dijë se çka po lexoj. Kishin kaluar disa vite nga rasti i takimit të parë me te, kur ai veç tani ishte shpërngul me banim në Prishtinë, por pasi që e kishte shtëpinë ende në Mitrovicë vinte kohë pas kohe. Një natë rastësisht u takuam para shtëpisë së tij, unë isha me shokët e mi duke dalë në qytet për një shëtitje, ndërsa axha Ahmet më ndali dhe nuk më lejoi të shkoi me ta por iu kërkoi falje dhe mua më futi në shtëpinë e tij. Ishte marsi i vitit 1991, dhe që nga kjo kohë e deri pak javë para shpërthimit të luftës në Kosovë ne kemi qenë vazhdimisht në kontakt. Në Mitrovicë vinte shpesh, por më tepër vetëm, se sa në shoqëri me dikë. Ndonjëherë e merrte me veti vajzën më të vogël Valbonën (tani nënë), për ta pastruar shtëpinë, dhe me ç’rast më thërriste mua, ajo na përgatite çajin, për derisa unë me te zhvillonim biseda nga të ndryshme duke qëndruar deri në orët e vona të natës. Nuk donte të rinte me askënd, përveç me mua por aty këtu në najë rast edhe me shokun tim Saad Gashin (tani magjistër i shkencave të kriminalistikës dhe autor i librit unikat në Kosovë “Konspiracioni dhe shoqatat sekrete”), babai i të cilit Riza Gashi (1916-1989), kishte qenë njeri i mençur dhe i lexueshëm, që posedonte një bibliotekë mjaftë të pasur, më shumë në gjuhën turke e sidomos në lëmin e masonerisë, për çka unë dhe axha Ahmet më së shumti diskutonim, dhe me ndonjë shok tjetër si më rrallë si bie fjala me Mursel Hazirin dhe Hamza Kralanin. Ai e dinte se literatura ime më e dashur ishte masoneria dhe shoqatat sekrete tjera të ngjashme me masonerinë. Mirëpo asokohe në gjuhën shqipe unë nuk di që kishte diku ndonjë libër apo artikull që shkruante në lidhje me këtë organizatë sekrete më të fuqishme në botë, atëherë unë isha i orientuar kah Beogradi, Zagrebi deri para shpërbërjes së Jugosllavisë Titoiste, dhe nga Turqia, nëpër librarit e të cilëve mund të gjendeshin libra me tema të tilla.

Në qershorin e vitit 1991, në përmes një studenti arab nga Iraku, i cili kishte studiuar në Mitrovicë, dhe nuk e dija arsyen e tij përse pas kryerjes së fakultetit nuk u kthye në vendlindje si shokët e tjerë të tij (dikush fliste se po i kryen punët e spiunazhit në interes të Jugosllavisë së atëhershme) më arritën nga Beogradi dy libra të cilat ka herë i kisha porositë: “Dashnoret e Josip Broz Titos”, nga autori Filip Radulloviq, dhe tjetra “Bota e fshehtë e masonerisë”, të autorit nga Maqedonia, Mihajlo Popovski. Libri i parë ka qenë i përgatitur për shtyp ende sa ka qenë gjallë vetë Titoja, por pas rishikimit të tij ani pse në fillim e kishte lejuar botimin e atij libri ai pastaj e ndaloi, dhe mezi që pas viteve të 90-ta e pa dritën e botimit. Po kështu ngjau edhe me librin e dytë e cila kah fundi i vitit 1983 dhe fillimi i vitit 1984, filloi të botohet në fillim si fejtun në gazetën e njohur të Beogradit “Ilustrovana politika”, që dilte një herë në javë. Fejtuni i këtij shkrimi doli vetëm në katër vazhdime, dhe censura e bëri të vetin duke mos e lënë të shkojë deri në fund. Autori M. Popovski pak muaj më vonë nuk e dimë se si arriti ta botojë këtë libër, e cila shumë shpejtë u tërhoq nga tregu prej organeve përgjegjëse të shtetit për censurë. Sipas një interviste të autorit të librit dhënë disa vite më vonë, aso kohe libri kishte arit të shitet vetëm në disa dhjetëra. Por pas rënies së komunizmit libri i njëjtë doli në treg në ribotim dhe u shit pa problem. Për këto dy libra unë i lajmërova axhës Ahmet menjëherë në telefon. Më tha në fund javë do të vi në Mitrovicë dhe do të bisedojmë.

Në shtunën e javës së fundit të qershorit 1991, axha Ahmet kishte arit nga Prishtina dhe në mbrëmje mu lajmërua me telefon që të shkoj tek ai dhe ti solli ato dy libra me veti. Unë ashtu veprova, dhe duke menduar se do ta befasojë me ca të dhëna nga ato dy libra, ai nuk më la me fol por ia nisi vetë. Vetëm njëherë ia lëshoj sytë kopertinave të librave dhe më tha: “Shevki këtu ka gjëra për të cilat unë jam informua ma herët, dhe menjëherë filloi me Titon duke më thënë a të kujtohej kur të tregoja se Tito ka pas shumë gra tjera përveç asaj zyrtare që e dimë, dhe se njëra prej atyre shumë grave të tija ka qenë ajo nga Turqia, Zuhra Reuf, si dhe Tito ka ditë me fol gjuhën Turke. Të shtoj se në një bisedë më të hershme me axhën Ahmet që patëm zhvilluar për Titon ai me të vërtetë me pat thënë se ai ka pas shumë gra (jashtëmartesore) dhe se ka njohur disa gjuhë botërore në mesin e tyre edhe gjuhën turke, dhe njëra prej atyre shumë grave jashtëmartesore ka qenë bija i një pronari të një miniere të arit në Turqi me të cilën i kishte lind një djalë, emrin nuk ia dinte, mirëpo pasi pohova se ashtu po shkruan edhe në libër atëherë i tregoja si quhej.” Unë mbeta si i shtangur. Ndërsa për librin e dytë nuk diskutuam shumë sepse me vete i kishte soll dy nga ato katër vazhdime të gazetës së përmendur më lartë, me çka ma bëri me dije se edhe për këtë jam i informuar.” Por prapë se prapë ai i mori të dy ato libra me veti në Prishtinë për me i lexuar më në detaje. Që nga kjo kohë e deri sa kanë zgjatë kontaktet e mija me axhën Ahmet unë vazhdimisht i kamë ofruar libra të ndryshme për lexim dhe studim të tyre, por ma së shumti me ato të përmbajtjes konspirative të organizatës së fuqishme sekrete të masonerisë.

Pas një kohe, pasi që mi kthej librat, ashtu në bisedë e sipër më tregonte gjëra interesante nga koha e Isa Boletinit, Hasan Prishtinës, Azem Bejtës, Hazhi Zekës, pastaj për një polemikë të ashpër mes Shahin Kolonjës dhe Faik Konicës të cilët gati se edhe fizikisht ishin ngatërruar, por falë durimit të z. Shahin Kolonjës, kjo polemikë kishte kaluar pa eksese. Faik bej Konica në stilin e tij siç ka dit dhe ka muajt vet, e kishte ofenduar me ca fjalë Shahin bej Kolonjën. Në pyetjen time cili kishte qenë motivi shtyrës për këtë mos marrëveshje që aq shumë e paska nervozuar Faik bej Koicën sa që gati edhe fizikisht me hy në konflikt? Axha Ahmet më tha se ata dy pas disa bisedave normale të

zhvilluara atë ditë, për një çast rroken për dy kolos të letërsisë botërore, për Shekspirin dhe Tolstoin. Deri sa Shahin bej Kolonja ia mbante anën më tepër Shekspirin, ndërsa Faik bej Konica, nuk pret as një as dy dhe me zë të ngritur dhe ashpër i drejtohet: “Ore ti, pos dy tre gjuhëve të huaja që i njeh, duhet ende të lexosh që ta kuptosh më mirë Shekspirin. A e sheh se nuk ke njohuri, dhe se nuk i ke lexuar shkrimet e Tolstoit “Për Shekspirin dhe dramën”, ku ky gjigant i letrave ruse dhe botërore i prezanton mendimet dhe analizat e veta krejtësisht ndryshe nga ajo që di bota për veprat e Shekspirin.” Me këtë rast më tregoi edhe gjëra tjera interesante në lidhje me polemikat e zhvilluara në mes këtyre dy rilindëseve tanë, që sipas njohurive të mija që të dy këta ishin me një kulturë të lartë enciklopedike. Është interesant me këtë rast të theksoj, se shumë vjet pas kësaj bisede me axhën Ahmet, mua më ra në dorë një katalog librash nga biblioteka e ashtuquajtur “Genij e geni ju sve najgore” (Gjeniu për gjenin gjithçka më keq), botuar në Beograd. Në mesin e shumë librave të prezantuara në këtë katalog mua ma tërhoqi vëmendjen njëra, të cilën e kishte shkruar shkrimtari i madh rus dhe botëror Tollstoi me titull “Për Shekspirin dhe dramën”. Nuk prita dhe menjëherë nëpërmes telefonit i porosita dy ekzemplar, një për veti dhe një për axhën Ahmet. Mirëpo pasi që axhen Ahmet se takova një kohë të gjatë sepse nuk vinte në Mitrovicë, unë në bisedë e sipër me një mik Skender Sadiku, të cilit ia tregova këtë libërth, ai ma huazoi dhe drejt ia dërgoi në Prishtinë publicistit dhe dramaturgut të njohur Haqif Mulliqi. Libri u humb, nuk mu kthye më në duar. Ia kërkoi Skenderit, më thoshte se Haqifi ia ka dhënë Fadil Hysës e kështu me radhë. Nuk u mërzita shumë pasi që e kisha edhe një në shtëpi. Më vonë këtë libër që e kisha në bibliotekën time personale, nga frika mos po mbes edhe pa te unë vetë e fotokopjova dhe ashtu ia dhashë axhës Ahmet. Kur i tregova çka ka ndodh, ai tepër shumë më qortoi duke më thënë: “Kur më do të mbushesh mend o djalë, nuk më dëgjon mua që kam përvojë të hidhur me njerëz, por po vepron sipas mendjes tënde.” Unë u mundova me u arsyetuar në një mënyrë, sepse z. Haqif Mulliqi aso kohe në bashkëpunim me Bajrush Morinën botonte përdyjavshmen “Gazeta Shqiptare”, në të cilën unë përmes shokut Skender Sadiku-t që e ceka më lartë e dërgova në botim shkrimin për vrasjen e kryetarit amerikan Kenedi. Për çudi, materialin që ua dërgova e botuan në tre vazhdime, por nuk shkuan deri në fund. Lexuesit aso kohe mbetën pa epilogun e qartë të ngjarjes, sepse në fund të vazhdimit të tretë shkruante: vijon sikurse në dy numrat paraprak. Ndërsa shkrimi nuk vijojë më. Ndërkaq, befasia më e madhe për mua ndodhi sepse në vazhdimin e parë nuk e kishin shënuar emrin e autorit të shkrimit. Nëpërmes telefonit bisedova me Haqifin i cili kërkoi falje për këtë lëshim. Mirëpo lëshime ndodhën edhe në vazhdimin e dytë dhe të tretë, sepse prapë nuk qëndronte emri i vërtet i autorit të shkrimit. Herën e dytë shkruante Ekrem Voca ndërsa herën e tretë Shefqet Voca në vend se me qenë Shevki Voca. Haqifi u hidhërua dhe të gjitha fajet ia hodhi Bajrushit, i cili me të vërtet në kontakt me mua me telefon u tregua mjaft arrogant dhe aspak i arsyeshëm, përkundër Haqifit i cili më dukej më i sjellshëm dhe më xhentëlmen. (Në fletoret e ditarit tim i kam të shënuara datat, orët dhe bisedat e zhvilluara me të dytë). Në fillim të dhjetorit të vitit 2005 e përditshmja “ZËRI”, falë Z. Ibrahim Kadriut ma botoi në katër vazhdime materialin në fjalë por, tani me plotësime dhe më mirë të shtjelluar.

Pa dyshim se axha Ahmet ishte njohës i shkëlqyeshëm, i rrjedhave të historisë së civilizimit botëror, themelimit dhe krijimit të shteteve, deri tek kryetarët dhe mbretërit e tyre. Më thoshte ti Shevki pasi që, bukur shumë po lexon literaturë të shoqatave sekrete, e sidomos ato të masonerisë, do të bindesh, ndoshta edhe je bind se, luftërat, revolucionet,

kryengritjet, montimet e ndryshme politike si dhe atentatet ndaj njerëzve të mëdhenj, janë vepër e masonëve dhe atyre që janë ngjashëm me ta. Ndërhyra duke theksuar bar në 250 vitet e fundit, çudi, nuk reagoi për këtë ndërhyrje nga ana ime. Me që axha Ahmet shpesh herë më epte përparësi në këtë drejtim, unë në ndonjë rast nuk pajtohesha me te. Biseda bëhej më atraktive kur e kundërshtoja ndonjëherë. Bie fjala ai në vitet 1995-1996, kishte filluar ti sistemoj të gjitha shkrimet dhe informatat që i kishte gjurmuar dhe grumbulluar gjatë tërë jetës për Isa Boletinin. Tani kërkonte ndihmën time nëse kamë ndonjë informatë për shqiptarët që kanë qenë anëtarë të lozhave të masonerisë. Me atë rast unë i thashë: “Axha Ahmet, sa më përket mua të tregoj se unë nuk i rreshtoj njerëzit në radhët e masonerisë vetëm nëse ata kanë pas apo kanë ndonjë pozitë të lartë politik, ushtarak apo diç tjetër si bie fjala biznesmen të suksesshëm e tjera. Sepse të thuash sot filan personi ka qenë apo është mason duhet të kesh argumente të forta. Kërkohet viti i pranimit në anëtarësimin e lozhës masone, pastaj vendi dhe emri i lozhës, numri rendor (një lloj i letërnjoftimit për arkivat e masonerisë), si dhe emri konspirativ i personit.” Ai sikur u hidhërua dhe më tha: “O djalë mos më mbaj mua ligjërrata, a pak gjëra deri sot ke mësua nga unë, dhe ende vazhdon të mësosh, por nëse ke diç më jep të lutem,” dhe vazhdojë të më tregojë për përgatitjen e librit për Isa Boletinin. Pasi ia përmenda disa nga emrat e njohura të shqiptarëve të cilët kanë qenë të kyçur nëpër lozhat e masonerisë, si për shembull: Ismail Qemali, Nikolla Ivanaj, Ibrahim Temo, Ahmet Njazi (Resneliu), Esat pashë Toptani, Arif Hikmeti, e disa të tjerë, ai nuk u nda i kënaqur. Insistonte gjithsesi që ta ceku edhe Hasan Prishtinën dhe Nexhip Dragën. Mirëpo, sa e sa herë i thashë që për Hasan Prishtinën nuk kam të dhëna që ka qenë masonë ndërkaq, a ju ka shërbyer ai masonëve është diçka tjetër. Jo, më thoshte prej Lidhjes së Prizrenit 1878 e këndeje ka pas mjaft shqiptarë të kyçur në masoneri, por mua më duhen më tepër argumente, dhe i përmendi ca emra, që unë për veti edhe pse kisha mjaft informata për masonët në përgjithësi, nuk doja të pranoja se ata kanë qenë masonë. I tregova se në librin “Masoni u Jugosllaviji 1764-1980” të autorit nga Beogradi e njëherë edhe kryemjeshtër i shkallës 33-të në masoneri të Jugosllavisë së viteve 90-ta, Zoran Nenezic, në të cilën ai thekson lidhshmërinë dhe solidaritetin e vëllezërve mason kudo qofshin ata në botë duke sjellë një argument se si masonët serb kërkojnë nga Orienti i Madh (lozha më e madhe), që të intervenojnë tek vëllezërit e tyre masonë turk që ta ndalin represionin dhe dhunën ndaj popullatës krishtere, ndërsa këta si kundërshtpërblim, kërkojnë që disa turq dhe shqiptar mason që gjenden të burgosur në Beograd të lirohen, (faqe 284, viti 1988). Ky rast ka ndodh kah fundi i vitit 1912 dhe fillimi i vitit 1913, kur aso kohe në Beograd ishin të burgosur Hasan Prishtina, Nexhip Draga dhe 12 shqiptarë tjerë. Pastaj ma kërkoi librin të cilën e murrë me veti në Prishtinë dhe e mbajti gati dy vite, si dhe disa fejtone e artikuj nga gazeta dhe revista të ndryshme të kohës së Jugosllavisë Titoiste, por edhe të kohës së Millosheviqit. Në mesin e tyre ishte edhe fejtone në tre vazhdime i shkruar nga Bogumil Hrabak me titull: “Roli i masonëve në krijimin e Jugosllavisë”. Pas këtij rasti, thua se sa herë që vinte në Mitrovicë dhe takohej me mua më thoshte: “A po she, edhe e ke lexuar edhe nuk pranon që Hasan Prishtina ka qenë masonë. Unë mbaja qëndrimin tim sikur që kam cek edhe më lartë, se duhet pasur argumente më konkrete dhe më të fuqishme.

Ndodhi që në vitin 1997 ai ta botoi librin për “Isa Boletinin...” siç e kemi cekë edhe më lartë, dhe në faqen 272 të saj i plasoi ato pjesë nga libri i Zoran Neneziçit që e zumë në gojë më parë. Mirëpo në ndërkohë, si zakonisht sipas porosisë time më vinin libra nga Beogradi. Në fillim të vitit 1998 më arriti një libër dy vëllimshme me ekzemplar shumë të kufizuar dhe përkthyer nga anglishtja “Leksikoni i masonëve të lozhave të Ballkanit” nga dy autor të regjistruar vetëm me initiale. Unë nuk rrija i qetë vazhdimisht interesohesha për libra me tematikë të tillë. Kisha mjaft vështirësi për ti siguruar por ia aria disi. Ky libër në dy vëllime ishte e ilustruar me fotografi dhe kishte të dhëna shumë interesante për personat që përfshiheshin aty. Libri përfshinë edhe një numër të shqiptarëve por, Hasan Prishtina as aty nuk gjendet. Dhe me ç’rast i pata treguar axhës Ahmet për këto dy libra, ai i kërkonte ti merë me veti në Prishtinë, por për kundër respektit, nderit dhe dashurisë që kisha ndaj tij unë nuk ia dhashë, vetëm sa i pa kur erdhi një ditë te unë në Mitrovicë. I thash sikur ta kisha këtë libër para se ti ta botoje librin për Isa Boletinin kisha me ta dhanë, por tani mbasi e ke kryer punën kryesore me librin e po sa



Pertev Badivuku, Sadakatja (vajza e bijësuar e Hasan Prishtinës) dhe prof. Ahmet Maloku. Fotografuar me 20 gusht, 1978, para bustit të Hasan Prishtinës, te Sh. M. N. Në Mitrovicë. Nëna e Pertevit (1906-1991), Besimja ka qenë kushërirë e parë me Hasan Prishtinën.

botuar kjo nuk ja vlen. Edhe pse herë pas here nuk pajtoheshim dhe nuk na përputheshin mendimet për rastet dhe ngjarjet të ndryshme, e sidomos kur ishin temat e nxehta si për shembull kur bisedonim për lëvizjen e masonerisë, unë nuk guxoj dhe nuk kam potencial intelektual dhe informativ që t’ia mohoj diturin, leximin e në veçanti analizat tepër të qëlluara, qofshin të rrafshit politik, historik apo të ndonjë fushe tjetër, sepse me të vërtet ka qenë një person me dije, lexim dhe informim të hatashëm dhe vështir se dikush ia ka dal në krye me te. Ai për një çast sa ishim ashtu duke biseduar në ato momente heshti për një gjysmë minutë dhe me kokë të kthyer poshtë dhe me tre gishtat e parë të dorës së djathtë duke fërkuar ballin mendoj pak, e pastaj ngriti kokën dhe më tha: “Shevki, dëgjomë, të kam lakmi që po lexon dhe po i gjen do libra që nuk është lehtë njeriu të vij deri te ato, por, po të flas për veti, se sa i përket meje as kjo nuk është argument që Hasan Prishtina nuk ka qenë masonë. Nëse pyet përse ja të tregoi. A po e lexon me vëmendje titullin e librit “Leksikon masona Balkanskih loza”, i thash po, atëherë vazhdoi dhe më tha, pra këtu mund të përfshihen vetëm ata mason që kanë qenë nëpër lozhat e masonerisë të vendeve të Ballkanit, ndërsa Hasan Prishtina, pas shkatërrimit të Perandorisë Osmane, ka pas lidhje të forta edhe me Francën edhe me Austrinë, e sidomos

me këtë të dytin, dhe shumë normale është që mos të përfshihet këtu, në regjistrin e emrave ma masonët e shteteve Ballkanike. Sepse sikurse që dihet as njëra prej këtyre dy shteteve për nga territori nuk i takojnë vendeve Ballkanike. Ndërkaq që Hasani i ka taku ndonjërisë prej logjeve të perëndimit, dhe kurdo qoftë kjo punë e tij do të dal në shesh, mu ashtu me argumente siç po e kërkon ti.” Çka ti bësh mu deshtë të heshti sepse pranë tij dukësia tepër i vogël si zogu para shqiptonjës së madhe, apo krapa (një peshk i lumenjve tanë Sh. V.) pranë një balene. Dituria e tij dhe prognozatat e forta mua më gëlltitnin tërësisht.

Krahas diturive dhe njohurive të mrekullueshme të rrethanave shoqërore politike ndërkombëtare, ai kishte një bagazh të pasur të diturisë për të kaluarën e hidhur të historisë tonë kombëtare. Vazhdimisht më thoshte: “ Kamë frikë se Evropa dhe perëndimi do të na tradhtojnë. Shqiptarët në përgjithësi kanë një përvojë të hidhur diplomatike me shtetet e perëndimit. Disa herë na copëtuan duke na i shkëputur territoret tona autoktone me ia dhënë tjetër kujt.” Ndërsa unë në disa raste i thosha jo bre axha Ahmet mos u banë kaq pesimist, tani shqiptarët nuk janë ata të para 100 apo 200 vjetëve, tash falë Zotit kemi njerëz të shkolluar dhe të ditur mjaft. Në këtë kontekst ma përmendke shumë shpesh Mitrovicën, duke më thënë udhëheqësit tonë duhet të jenë shumë syhapur dhe këmbëngulës që assesi mos të lejojnë ndarjen e territorit të Kosovës apo të shkëmbimit të ndonjë pjese të saj me ndonjë territor tjetër, siç ndodhi para ca vjetëve me një iniciativë nga disa intelektual tanë mjerisht aspak të ditur dhe vizionar. Pyetja ime që ia shtrova me këtë rast ishte: “Përse po e cekë vetëm Mitrovicën, e jo edhe ndonjë pjesë tjetër të Kosovës, që ruana Zot mos të lejohet të vjen deri te ndarja e saj, a vetëm për shkak të minierës Trepça? Përgjigja e tij ishte shumë e arsyeshme dhe me plot argumente. Më tha dëgjomë Shevki: “Kur po përmendet Mitrovica shumë kush po mendon se vetëm Trepça është në pyetje. Por unë të tregoi se Mitrovica me rrethinë që shtrihet deri nja shtatë kilometra pranë Rashkës, duke përfshirë Leshakun, Leposaviqin, Soçanicën e Bello-Bërdën para vitit 1912 dhe pas vitit 1945 është çelësi i Portës së Ballkanit, është Nili i Ballkanit, është Otrant i Ballkanit, është Dardanel i Ballkanit, është Eufrat e Tigër i Ballkanit dhe si e tillë Hyjni e Kosovës. Trepça, që po e përmend ti o Shevki, me thëngjillin e Obiliqit, dhe Kishnicës i kanë vitet e numëruara të eksploatimit. Ndërsa rol kryesor këtu ka Ibri (tani Lumëbardhi) në Gazivodë që janë të pa vdekshme. Ajo me një akumulim të ujit prej 370 milion m.3 e shuan etjen në Kosovë. Furnizon me ujë të pijshëm Mitrovicën me rrethinë, Skenderajn me rrethinë, Vushtrrinë me rrethinë; ujit arat e Kosovës deri në Gërlicë të Ferizajt, Drenica e Pashës furnizon me ujë termocentralin “Kosova B”, industrinë kimiko-metalurgjike të Trepçës. Është det i Kosovës ku gjatë tërë verës lahen në të dy anët e brigjeve të tij qytetarët e Mitrovicës, Vushtrrisë, Skenderajt dhe të fshatrave për rreth. Pra për atë po them se asnjë gur a bos i Kosovës nuk guxon të lëkundet e të del në treg për t’u shkëmbyer as për gjysmën e Ballkanit, e çfarëdo çmimi tjetër. Shkëmbimi i tokave shqiptare me tokat shqiptare do të ishte një akt i shëmtuar aventurierësh e tradhtarësh të cilën populli shqiptar kurrë nuk do ta pranonte.” Këto fjalë mi ka thënë sa e sa herë, deri sa më në fund pasi që shkrimet e tija sa vizionare aq edhe thumbuese për shumë kënd nuk ishin të mirëseardhura, ai u detyrua që të gjitha materialet prej vitit 1970 e këndeje të cilat nuk ia botonin asnjëra nga revistat apo gazetatat e kohës, ti botojë në libra të veçanta me financimet e veta personale. Këto fjalë vizionare të profesorit të nderuar unë i paraqita nga fletoret e mija të shënimeve të cilat kohë pas kohe i merrja prej tij. Ndërsa lexuesit nëse dëshirojnë të dinë më shumë rreth këtyre çështjeve

mund t'i gjejnë në librin e tij "ISA BOLETINI-integruesi i parë i të gjitha trojeve etnike shqiptare", Prishtinë, 1997.

Ishte diku kah gjysma e dytë e dhjetorit (18, e hënë) 1995, kur axha Ahmet rreth orës 11 paradite mu lajmërua me telefon nga shtëpia e tij në Mitrovicë. Më tregoi se po sa kishte arit nga Prishtina dhe më tha nëse je në mbrëmje në shtëpi dhe ke kohë do të vi të takohemi, sepse sonte do të qëndrojë në Mitrovicë. Po si jo o axha Ahmet në çdo kohë jam i përgatitur për juve pa marrë parasysh se a e kamë ndonjë mysafir, apo ndonjë punë. Ju, tek unë jeni mysafir i veçuar nga të gjithë të tjerët. I vinte shumë mirë kur e pritja me këto fjalë. Dhe diku rreth orës 18 erdh. Si zakonisht biseda fillonte për problemet tona të përditshme politike në Kosovë siç ndodhte zakonisht në atë kohë, nga problemet që na shkaktonin policët serbo çetnik të Millosheviqit, duke filluar nga rrahjet, plaçkitje nëpër shtëpia dhe nëpër tregje në pikë të ditës, hyrje në orët e hershme të mëngjesit nëpër banesa dhe shtëpia me motive që për ta çdoherë kishin arsye, dhuna nga të ndryshme etj.

Pas pak më pyeti a e njoh profesorin dhe publicistin Fazli Hajrizi. I thash personalisht nuk e njoh, përveç përmes shkrimeve që po i publikon, të cilat kur po mundem me i zanë në gazeta po ia lexoi dhe po i ruaj në arkivin tim bashkë me bibliotekën. Axha Ahmet e njihte mirë dhe më tregoi se është nga fshati Kotor, por jeton në Mitrovicë dhe ligjëron gjuhën shqipe në shkollën e mesme të gjimnazit në Mitrovicë. Pas kësaj që më tregoi unë kalova për pak qaste në dhomën ku e kisha bibliotekën dhe e solla shkrimin e Fazliut të botuar gati dy muaj më parë në gazetën "BUJKU", në rubrikën e fejtoneve për patriotin, atdhetarin, dashamirin e arsimit shqiptar Bedri Xhinaj, të cilën e kishte shkruar ai vetë. Ndërkaq axha Ahmet më tha unë për këtë edhe desha me të pyet, se a pate mundësi me përcjellë deri në fund. I thash ja ta solla, përpara e ke (fejtoni u botua në tetë vazhdime, prej 14 tetor 1995 e shtunë, deri më 23 tetor e hënë, me që gazeta "BUJKU" nuk dilte të dielave SH. V.), dhe vazhdova duke i treguar se pas përfundimit të fejtonit unë bisedova me një maturan të gjimnazit Bedri Bala nxënës i Fazliut dhe nxënësi më i mirë në klasë, me të cilin kisha kontakte kohë pas kohe se ai kishte nevojë për libra dhe informata të ndryshme për shkollë të cilat me lehtësi i gjente tek unë. Bedriut i pata treguar për këtë fejton në lidhje me disa lëshime që ishin bërë. Ndërkaq që ky i tregon profesorit të vetë për mua, andaj ai shpreh dëshirë që të njoftohet, dhe i thotë Bedriut pyete Shevkium kur është i lirë të shkojmë tek ai dhe të bisedojmë pak. E tani kur do të vijnë nuk e di. Me këtë rast axha Ahmet më pyeti se nëse e kam lexuar shkrimin me vëmendje (sepse ai nuk kishte mundë me i përcjell gjitha vazhdimet), a theksohet kund rasti i vitit 1942, kur Bedri Xhinaj organizoi demonstrata dhe protesta të mëdha në Mitrovicë, si dhe e mbajti një fjalim madhështor me rastin e vrasjes dhe zhdukjes së tre tregtarëve shqiptar nga Mitrovica, në Leshak, nga ana e serbo çetnikëve. Me që për këtë rast kisha edhe unë ca informata që i kisha mbledhur së pari nga nëna ime dhe nga qytetarë tjerë të Mitrovicës, i thash jo, nuk e përmend këtë rast askund në shkrim, për çka edhe unë shumë isha i interesuar ta shoh si i përshkruan vetë Fazliu ato ngjarje. Atëherë axha Ahmet më pyeti se çka di unë për at rast duke më thanë fillo të tregosh deri sa unë do të dëgjoj me vëmendje. Unë fillova ti tregoi se me 2 shkurt 1942, nisen nga Mitrovica tre tregtar të njohur të qytetit për serbi që të marrin mall për furnizimin e depove dhe dyqaneve të tyre. Ndërhyri Axha Ahmet duke më thanë kush kanë qenë ata? Ata sipas të dhënave që unë i kamë ishin: Jahja Zhubi, Abedin Jolla dhe Çazim Kalaveshi. Këta tre, vazhdova unë me aq sa kisha informata nuk janë marrë me politik, kanë qenë tregtar që kanë punuar me shumicë, dhe i kanë furnizuar qytetarët e Mitrovicës me gjëra elementare të nevojshme për

ekzistencë. Në Leshak këta tre bashkë me disa koleg tregtar tjerë të nacionalitetit serb, i kanë zbrit nga treni me motiv të verifikimit të dokumentacionit, mirëpo serbët që kanë qenë me këta tre i kanë nda menjëherë, ndërsa Jahjan, Abedinin dhe Çazimin i kanë vra diku në malet e Leshakut dhe asnjëherë nuk janë gjetur kufomat e tyre. Më pyeti axha Ahmet nga kush i kanë këto të dhëna? I tregova se në fillim mi ka tregu nëna sepse po at ditë me këta tre ka pas me marrë rrugë edhe gjyshi im në vijë të nënës Jusuf Qoroviqi (1900-1987) i cili e ka mbajtur një dyqan në Mitrovicë, dhe po të shkoja, edhe ky me siguri do të vritej nga serbo çetnikët, pastaj rrëfimtari tjetër janë (aso kohe kur unë zhvilloja këtë bisedë me axhën Ahmet të gjithë këta ishin gjallë përveç Halil Abrashit), Mustaf Vitaku, Njazi Prekazi (me të cilin kaloja orë të tëra në bisedime të ndryshme, me ç'rast përfitoja informata dhe njohuri nga ngjarjet e së kaluarës të qytetit të Mitrovicës për çka unë interesohesha, të cilat ai i mbante mirë në mend dhe i rrëfente për mrekulli), Ismajl Alushi, Halil Abrashi, axha im Bajram Voca etj. Për të gjitha këto biseda i kam datat e shënuara. Pastaj axha Ahmet nuk më la të vazhdojë më tutje por e mori fjalën ndër të cilat theksojë: “Shevki at ditë me të mbërritur lajmi në Mitrovicë për vrasjen e këtyre tre qytetarëve, në qytet u krijua një gjendje e jashtëzakonshme. Bedri Xhinaj ishte ai që organizoi protesta dhe demonstrata të mëdha në qytet në shenjë revolte ndaj kësaj veprë tradhtare nga ana e serbëve ku para masës së madhe të qytetarëve të indinjuar dhe të mllefosur mbajti një fjalim të zjarrtë para bashkisë së qytetit. Mirëpo ato që ti nuk i ceke, po ti tregoi unë se situata menjëherë pas fjalimit të Bedri Xhinajt eskaloj dhe doli nga kontrolli. Masa e qytetarëve të tubuar filluan ti sulmojnë serbët dhe pronat e tyre në shenjë hakmarrjeje, me ç'rast shumë serb u rrahën dhe shumë shitore të tyre u dogjën. Qytetari Sylejman (Syli) A. Misini dhe Ejup Burgi Deva e rrahën për spital tregtarin e njohur dhe më të pasur në qytet Zharkoviçin, plaku Tahir Zasella i shkaktoi plagë të rënda një serbi tjetër me mbiemrin Stojadinoviç. Tahir Kosterci me bastun (kroç) në dorë rrah një serb deri në vdekje.” Pastaj unë ndërhyra dhe i thash Axha Ahmet për disa nga këto raste edhe unë kam informata, por kështu me emra sikurse ju që i cekni jo, përveç se kur e pata pyetur axhën tim Bajram Voca (ende gjallë 79 vjeçar) më pati treguar se edhe vëllai i tij i madhi Emin Voca (1915-1969) do me thënë axha im më i madhi nga shtatë vëllezër sa kanë qenë, duke ia rrëmbyer bastunin nga dora plakut Tahir Kosterci, e zënë një serb dhe e rrah shumë, emri i atij serbi axhës tim nuk ju kujtoje. Aty pari duke rrahur Eminin serbin, qëllon Pajazit Boletini i veshur me uniform Xhandari, dhe me një zë pak ca të ngritur thotë: “O Emin mos sill bre, mos sill, ndërsa më ngadalë i thotë të kundërtën myte shkaun, myte mos te dhimet. Pastaj axha Ahmet vazhdoi dhe tha këtë nuk e kam ditë dhe e shënoj në një pjesë të letrës të cilën unë ia huazova duke më thënë se edhe kjo është pjesë e historisë së asaj dite, dhe vazhdojë me pjesën tjetër të ditës së njëjtë duke më treguar se at ditë sa kanë zgjatë protestat dhe demonstratat në qytet, protestuesve falas bukën ua ka siguruar pasaniku nga Mitrovica Sylejman Nishliu i cili në qendër të qytetit e ka pas furën e bukëpjekësit, dhe gati se tërë ditën ka shpërndarë bukë pa pare. Atë natë ndejti deri rreth orës 23 dhe para se të përshëndetet me mua më tha nëse takohesh me Fazliun tregoj edhe këtë detaj të jetës së Bedri Xhinaj.

Dy tre ditë para vitit të Ri 1996, saktësisht me 28 dhjetor 1995 e enjte në mbrëmje rreth orës 19, erdh profesor Fazli Hajrizi me gjithë nxënësin e tij Bedri Balën. Ishte, pra hera e parë që po rrimë dhe po bisedojmë me Fazliun. Ishte i qetë dhe fliste ngadalë, bukur dhe rrjedhshëm, ndërsa unë nuk e kisha at filozofi të të folurit. Atë natë biseduam shumë gjëra, më tepër për historinë tonë kombëtare e sidomos për personalitet e rilindjes

kombëtare qofshin ata të politikës e të diplomacisë qofshin krijues letrar dhe të tjerë, që gjatë regjimit komunist tërësisht kanë qenë në listën e zi ose për të keq ose për tradhti, me një fjalë të anatemuar. Ai si me habi dhe çudi më dëgjonte kur unë diç filloja të tregojë nga opusi im i leximit dhe informimit, si bie fjala për Gjergj Fishtë, Faik Konicën, Dimitër Pashkon, pastaj për polemikat e Aleksandër Xhuvanit dhe Fan Nolit, në lidhje me pastrimin e gjuhës shqipe që Xhuvani ia adresonte Nolit, të zhvilluara në gazetën “Shkreptima” të Kajros. Për qëndrimin e pastrimit të gjuhës shqipe që udhëhiqte Xhuvani, për çka thoshte: “Huazime assesi, duke pas na gjuhën tonë të pastër dhe të pasur” etj. Fazliu më tha përse edhe ti nuk merresh me shkrime? I thash ende nuk jam i përgatitur, ndonëse kam pas në fillim të viteve të 90-ta ca reagime në ndonjë shkrim apo fejtton, por u tërhoqa sepse nuk mi botonin. Për momentin jam duke sistemuar informatat e tubuara qofshin nga librat qofshin nga gazeta, revista apo edhe nga përcjellja e emisioneve nëpër radio dhe televizion që kanë të bëjnë me vrasjen e kryetarit Amerikan Kenedi. Fazliut ia përcjella porosinë e axhës Ahmet, të cilin edhe ai e njihte shumë mirë. Më tha o Shevki kam dëshirë mjaft të ri me te dhe ti mblodhi ca informata sepse e di që ai është thujse unikat në këtë drejtim, por vështirë me hy në kontakt me te. Pastaj Fazliu më tregoi se dashtë Zoti kam ndërmend kurdo qoftë që ta bëjë një libër monografik për Bedri Xhinaj e me at rast me siguri se do të lajmërohem edhe tek ti për ndonjë informatë. Fazliu me Bedriun atë natë ndejën tre orë e gjysmë dhe shkuan. Pas këtij rasti e deri në ditët e sodit Fazliu vazhdimisht mu ka lajmëruar me ç’rast i nevojitej ndonjë material apo informatë për shkrimet e tija përkatëse. Sipas meje, shokëve, dhe familjarëve të mijë, por edhe shënimeve të cilat i kamë evidentuar nëpër fletore, të gjitha kontaktet që i kam pas me Fazliun janë të njohura. Ai shkroi për Xhafer Devën, Mulla Ilijaz Brojën dhe Ibrahim Spahiun (babë e bir), Tafil Boletinin, Bedri Xhinajn (pas lufte botoi librin për te), Rexhep Mitrovicën, (për të cilën në fillim në “Bota Sot” botoi disa herë fejtton, tani në fund e qiti edhe librin monografik për te) për Mehmet Vokshin dhe pjesë fragmentare nga libri i tij “Shqipnija e shqiptarëve” botim i vitit 1930, të cilën unë ia dhashë me një marrëveshje, ndërsa ai e botoi fejtton në 12 vazhdime në “Rilindja”, pas luftës, në ç’mënyrë nuk doli si u patëm marrë vesh. Këtë libër ma kishte dhënë axha Ahmet, unë e fotokopjova por, me lejen e tij, Fazliu pastaj botoi librin monografik për gjimnazin e Mitrovicës, dhe libra tjerë si për shembull “Vëzhgime për Shalën e Bajgores”, monografinë për normalen Hasan Prishtina të Mitrovicës të cilën e kemi cekë më lartë në disa raste etj. Një javë pas vdekjes së axhës Ahmet, Fazliu ia behu herët në mëngjes tek unë dhe mblodhi ca informata ku shkroi dhe botoi shkrimin për te, të cilat u botuan në dy gazeta. E para në “RILINDJA” me 3 nëntor, 1999, e mërkurë faqe 6, dhe i njëjti në “Shkëndija” Mars 2000, faqe 8, e shumë e shumë shkrime dhe informata tjera që i nevojiteshin. Ai edhe tani pasi jam shpërngul nga Mitrovica në Prizren, kohë pas kohe më lajmërohet me telefon kur i paraqitet nevoja për ndonjë libër apo informatë. Për shembull me 3 gusht 2009, e hënë rreth orës 12 më thirri në telefon dhe ma bëri me dije se ma kishte siguruar librin e tij të fundit “Rexhep Mitrovica në lëvizjen kombëtare”, të cilën e kishte lënë në Mitrovicë te Bedri Bala. Më tha: “Shevki e meriton ti këtë libër me ta dhurua duke i marrë parasysh ndihmat dhe informatat e kohë pas kobshme që i mera prej teje.” Librin ta kam lanë te Bedri Bala, kur me ndonjë rast vjen në Mitrovicë lajmëroresh te ai apo, nëse ai vjen te ti në Prizren ta sjellë. Për profesor Fazliun kam edhe shumë çka për të shtuar, por po e lë me kaq me që një ditë kamë ndërmend të shkruaj për njerëzit e qytetit tim (lexo intelektualët që në një mënyrë apo tjetër i kanë shërbyer kombit pa kursyer asgjë), me

ç'rast një vend të veçantë do ti kushtojë profesorit Fazli Hajrizi, si publicist dhe gjurmues i pa përtuar në ndriçimin e figurave kombëtare të cilët i kishte mbuluar pluhuri i kohës.

Profesor Ahmet Maloku përveç dijes, inteligjencës, dhe shkrimeve të cilat i hidhte në letër, ai u mor edhe me një veprimtari tjetër që shekuj me radhë ia piu gjakun popullit tonë. Ajo ishte pjesëmarrja dhe udhëheqja (jo aq sa duhet përkundër mençurisë që e kishte) e tij në pajtimin e gjaqeve. Unë këtë nuk e quaj aksioni i pajtimit të gjaqeve, sikurse që shumë kush e quan, sepse tradita jonë shqiptar kështu nuk e ka njohur. Kjo terminologji u përvetësua në kohën e sundimit të satrapit të Ballkanit Millosheviq, atëherë kur me iniciativën e të ndjerit Anton Qeta, të cilit iu bashkëngjitë edhe një grup intelektualësh të profileve të ndryshëm e filluan të ashtuquajturën aksioni për pajtimin e familjeve të armiqësuar mes veti, qoftë për vrasje, hakmarrje, grabitje të vajzave dhe konflikte me motive tjera. Deri para këtij të ashtuquajturë aksion i pajtimit të gjaqeve shumë rrallë apo, ndoshta edhe hiq, nuk mund të shifshi nëpër oda të fshatrave tona të ketë marrë pjesë ndonjë nga intelektualët për një gjest human sikurse që është pajtimi i dy apo më shumë familjeve të gjakosura mes veti, përveç atyre disa pleqnarëve, që për fat tani edhe ata janë rralluar mjaftë, të cilët me mençurin e dhuruar nga Zoti e arrinin qëllimin e pajtimit të familjeve në konflikt, ndonjëherë më shpejt dhe më lehtë, por ndonjëherë u merrte edhe kohë të gjatë, me që ndonjëra palë nuk pranonte lehtë ta fali gabimin e tjetrit.. Ndërsa profesor Ahmet Maloku e ka pas guximin që edhe atëherë të pajtoi dhe bashkoi shumë familje që ishin në konflikt. Tani edhe ai u kyç në karvanin për pajtimin masiv të gjaqeve. Në Mitrovicë vetë kam pas rast disa herë ta shohë kur ai arrinte duke i prirë masës pranë oborrit të xhamisë së quajtur “Haxhi Veseli” (emri i vërtet i xhamisë Hysen Qaush), dhe kryente me një disiplinë të madhe ceremoninë e pajtimit. Nuk lejonte të dëgjohen zëra pa nevojë dhe arsye. Menjëherë ndërhynte dhe ia epte fjalën atij që e kishte radhën. Aktiviteti i tij në këtë drejtim u shtri që nga fshatrat më të thella të Shalës së Bajgores e deri përtej Drenicës.

Herën e fundit para se të ndërronte jetë profesor Ahmet Maloku, më vizitoi në shtëpi me djalin e tij të madhin Bahriun. Ishte data 19-korrik, 1999 e premte, kur pak para orës 11 paradite ia behu tek unë. Ata erdhën me një veturë të cilën e voziste Bahriu. Ndërkaq tre ditë më parë unë kontaktova me te në telefon, me ç'rast më tha pritëm, dashtë Zoti brenda dy tre ditëve do të vi në Mitrovicë enkas me u taku me ty.

Pasi u ulën unë u ngrita sërish në këmbë dhe u afrova duke e përqaftuar dhe uruar çlirimin nga një okupim i gjatë klasik serbo-çetnik që kishte përjetuar Kosova. Të dyve na u mbushën sytë lot. Njëjtë veprovë edhe me djalin e tij. Axha Ahmet ishte i disponuar mjaft, por unë vëreja se kishte disa shenja të keqësimit të gjendjes shëndetësore. Më vërejti se po e shikoj me një breng dhe mërzi, atëherë mu drejtua sikur të ma lexoja mendjen: “Shevki neve na ndan një periudhë mjaft e gjatë kohore, ti dhe ky djali im dhe gjithë të tjerët që dhashë Zoti ta shijoni edhe shtetin si shtet që i ka hije më në fund Kosovës edhe njëherë po ju them urime, e urime, sepse mua ka filluar shëndeti të më lëshojë, andaj me siguri se nuk do të jemi edhe shumë kohë së bashku. Kjo është një realitet që çdokush që ka ardhë në këtë botë një ditë edhe do të ndahet prej saj. Unë u mërzita mjaftë, por u përmbajta disi.

Me veti e kishte sjellë librin e pestë me radhë “Dëshmi po-prask jo” të cilën ma dhuroi dhe më tha: “Nëse më jep Zoti shëndet shumë shpejt do të dal edhe me librin e gjashtë dhe të shtatë me radhë.” At ditë nuk ndëji si zakonisht që rinte me orë të tëra me mua, sepse djali i tij që e kishte sjell me vete në Mitrovicë, një, dy insistonte, qohu, qohu, po

qohemi babë se e din që kemi edhe ca punë tjera, përkundër insistimit të axhës Ahmet i cili vërehej shumë mirë se kishte dëshirë të kalonte edhe ca qaste me mua. Në ora 12 e 30 minuta i përcolla deri te hyrja dhe nisja e veturës. Nuk mundem dot assesi ta hoqi nga mendja shikimin e tij dhe përsëritjen që ma bënte nga vetura me dorë deri sa humbi dhe nuk dukej më. U ktheva brenda në shtëpi shumë i mërzitur. Dy fëmijët e mi Shabani (përtëritje e emrit të babait tim) aso kohe gjashtë vjeçar, dhe Jusufi 5 vjeçar, mu afruan dhe u ulën në prehrin tim. I madhi Shabani duke mi parë sytë e përplotura nuk foli asgjë vetëm se u ngulit thellë dika në mendime, ndërsa i dyti Jusufi që ende nuk fliste qartë, dhe si duhet, me një gjuhë simpatike më tha: “Kiki (kështu më thërrasin fëmijët e mi, fëmijët e vëllait dhe të dy motrave), pçe po kan, e pçe, kajgjom mu (përse po qanë, përse, tregomë mua) dhe tentonte me duart e vogla dhe të lëmuara të tija të mi fshij lotët që rrjedhin nga sytë e mi pa ndërpre.

Pas pak çastesh e lash më një anë librin, “Jevreji za slobodu Srbije 1912-1918” (“Hebrenjt për çlirimin e Serbisë 1912-1928”), botim i Beogradit 1995, të cilën ato ditë kisha filluar me lexuar, me që për çudinë tonë kishte të dhëna shumë interesante. Hebrenjtë si hebrenj, në cilën vend të botës qofshin, ata din të adaptohen në mesin ku jetojnë, sepse e posedojnë një mjeshtri të veçantë teknike për këtë çështje, pasi që dihet shumë mirë se ekonomikisht dhe materialisht janë shumë të fuqishëm. Më pas me pa durim e hapa librin e axhës Ahmet, të cilën shpejt e përfundova sepse në te kishte ribotuar shumë shkrime të cilat më herët mi kishte dhënë për ti fotokopjuar.

Pasi që ekonomikisht nuk qëndroja mirë, nuk kisha mundësi të shkojë deri në Prishtinë për ta vizituar, atëherë pas një kohe të vizitës së tij tek unë, ia bëra një telefon sa për tu informuar rreth gjendjes së tij shëndetësore. Ishte fundi i shtatorit (30)-1999, e enjte pas orës 17, andej lidhjes telefonike u paraqitë bashkëshortja e axhës Ahmet tezja Shemsije, një grua shumë fisnike për çdo lëvdatë. Pas përsëritjes time ajo më tregoi se axha Ahmet është shumë s’muet dhe është ligë tepër. Mirëpo me të dëgjuar se me kënd po flet ajo në telefon, ai shpejt reagoi (ia dëgjoja zërin edhe përse ishte në dhomën tjetër nga ku ndodhej telefoni). Ndal, ndalu, nal të flas me Shevkiun tim. Dëgjohej zëri i tij. Tezja Shemsije mendohej ti pengoj me që mjeku kishte dhënë terapi të cilave me përpikëri duhej ti përmbahej, fjala ishte që mos të qëndrojë në këmbë, mos ta lodhi veten, sa ma pak të flas etj, ai përkundër këtyre rregullave është qar nga shtrati dhe u afrua deri te telefoni për ti ndërruar ca fjalë me mua, e që njëherë as unë, por as ai, nuk e dinim se këto ishin fjalët e fundit që i këmbuem. Më kujtohet se e dëgjova tezën Shemsije të thotë me një zë të butë dhe ngadalë: “O Ahmet kadale bre, a të ka thanë mjeku mos mu lodh dhe mos me zgjat shumë në biseda se të keqësohet gjendja shëndetësore.” Axha Ahmet i tha: “Po shuj mori grua se vetëm këtë shok dhe mik e kamë, pastaj vazhdoi dhe më tregoi se gjendja shëndetësore tepër ju ka keqësuar, më tha i kam humb ndoshta më tepër se njëzet kilogram, qe sa kohë as nuk po ha as nuk po pi. I thash mos u mërzit o axha Ahmet, se dashtë Zoti sërish do të përmirësohesh dhe do të takohemi e ta vazhdojmë bisedën si çdoherë mu aty ku kemi mbet. Ma kthej, jo o Shevki jo, nuk po mërzitem se një ditë pa dyshim gjithë kemi me shkua aty ku e kemi vendin. Misioni i çdo njeriu dhe krijese tjetër në këtë botë është i caktuar nga Fuqiploti dhe të gjithë sërish tek ai do të kthehemi. Por dëgjomë edhe diçka, jam në përfundim e sipër të edhe dy librave tjerë, njëra i kushtohet më tepër të madhit Xhafer Deva, ndonëse për kah koha e aktivitetit politik shumë të shkurtë por tepër aktiv dhe të vrullshëm të tij. Atëherë si duket u lodh dhe nuk mundi më

tepër me qëndrua, dhe në shpejtësi u përshëndet me mua, pastaj i këmbeva edhe dy tre fjalë me tezën Shemsije dhe u përshëndetëm.

Vajzën e vogël Valbonën e kishe fejuar për Liridon Vatovcin djalin e Ahmet Vatovcit një aktivistit të dalluar të LDK-në Mitrovicë. Derisa bacën Ahmet e njohsha mirë dhe kisha biseda me te, djalin Liridonin nuk e njohsha fare. Në mëngjesin e hershëm të 24 tetorit 1999 e diel ora 8 e 15 minuta, shumë rrufeshëm u trokit dera e korridorit. Me të hapur derën e pash një djalosh të pa njohur. Menjëherë pas prezantimit si djali i Ahmet Vatocit, unë e ndërpreva duke i thënë: “A mos po donë me më thonë se ka ndërruar jetë axha Ahmet”? Djaloshi u shtang se nga po e di, dhe vazhdoi të më thotë se mbrëmë vonë Ahmet Maloku ka ndërruar jetë dhe anëtarët e familjes së tij pasi na lajmëruan neve si miq të ri menjëherë më thanë nesër herët në mëngjes së pari lajmëroi Shevki Vocës e pastaj të tjerëve me rend. Më tregoi se varrimi do të bëhet në varrezat e Prishtinës, dhe vazhdoi rrugën tjetër kah. Hyra brenda tepër i mërzhitur dhe i pikëlluar. Sillesha nëpër dhoma dhe korridor duke mos ditë se çka me bë.

Profesor Ahmeti u varros në varrezat e Prishtinës me nderimet e fundit që ia bënë ish nxënësit dhe studentët e tij që aq shumë i deshi në jetë, pastaj kolegët, bashkëvendësit dhe qytetarët e Prishtinës dhe më gjerë. Saktësisht doli ashtu si më tha disa muaj më par në shtëpinë time se jam i lodhur, dhe kam bë goxha do vjet, kam frikë se nuk do të arrijë ta shohë Kosovën ashtu si e kam parapa, me shtetin vet të pavarur, me udhëheqësin e tij shqiptare në krye, e pse jo edhe me simbolet e saja.

Profesor Ahmet Maloku pas veti la një opus mjaftë të gjerë të punimeve shkencore duke filluar nga fizika, kimia, gjeografia, letërsia, etnografia, historia, folkloristika etj. Ndër të cilat mund ti përmendim: “Pasuritë nëntokësore të Kosovës e Metohisë” (1953, këtë material e kishte shkruar gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak, dhe honorarin e paguar për këtë shkrim ia kishte adresuar babës vet Shaqir Malokut, ky as që kishte ditë se nga dhe kush po ia dërgon ato të holla Sh. V.), “Epoka e Atomit” (“Përparimi”, numër 5, 1955), “Zhvillimi i atomistikës prej Demokritit e deri në ditët tona” (1964), “Fjalë e të folme të rralla popullore”, (“Përparimi” numër 1,2,3,4,5,6,9,10,11,12-1961), “Disa shënime gjeografike mbi shalën e Bajgores”, “Disa shënime mbi përhapjen e fiseve në Kosovë e Metohi (“Përparimi” numër 1-2, 1963), “Besime e besëtytni në Shalë të Bajgores” (1963), “Smrekonica në unazë të Shalës së Bajgores” (1963), “Lojërat popullore në shalë të Bajgores” (1966), “Mydyrjeti i Banjskës” (botuar në pesë vazhdime në gazetën javore “Zveqan” tetor-nëntor 1966, ndërsa “Rilindja” vetëm një vazhdim, me 6-janar-1968 e shtunë), “Kisha e Sokolicës” (1966), “Kurioziteti i xhamisë së Trepçës” (1966), “Jeta dhe veprimtaria e Azem Bejtës” (botuar me vazhdime në “Zveqan” dhe në “Zani i Rinisë” (1967), “Sherif Voca i Shalës së Bajgores” (“Rilindja”, 3 dhjetor 1967), “Hasan Prishtina-jeta dhe veprimtaria e tij” (“Zani i Rinisë” në dhjetë vazhdime, 1967-1968), etj.

Ndërsa gjatë viteve 90-ta të shekullit të kaluar botoi disa vepra; “Ata gabo un qorto I” maj 1996, dhe “Ata gabo unë qorto II-shin”, gusht 1996, (vepra këto me shkrime publicistike); pastaj “Isa Boletini-integrist i parë i të gjitha trojeve etnike shqiptare” (1997); “Enciklopedik i vogëlth-politiko-etnologjiko-historike” (“shkurt 1998); “Dëshmi po-prask jo” (maj 1998). Këtu më duhet të theksoj diçka para se ta ceku edhe librin e gjashtë me radhë të tij. Kur më ra në dorë libri i Fazli Hajrizit “Shkolla Normale Hasan Prishtina e Mitrovicës-monografi” botuar më 2007, ai në faqen e 420 të librit me ç’rast paraqet të dhënat biografike të profesor Ahmet Malokut, në mes veprave të tija e cekë

edhe një të fundit me titull “Sqarime me peshë historike” (1999). Unë për këtë libër nuk kisha njohuri, andaj në bisedë telefonike që pata me z. Fazliun i cili më tregoi se ma kishte nda librin e fundit të tij për Rexhep Mitrovicën që kemi cekë më lartë, e shfrytëzova rastin dhe pyeta për këtë libër të axhës Ahmet. Fazliu më tha për nder unë nuk di, sepse krejt dy apo tre libra i kam të profesor Ahmet Malokut, por ato të dhëna biografike që gjenden në librin për shkollën e mesme normale HasanPrishtina, të Mitrovicës i kamë sipas të dhënave që mi ka dhënë djali i Profesorit Ahmet Maoku Bahriu, përndryshe unë as që e kamë parë atë libër-përfundoi me kaq Fazliu.

Në fund, nëse do ta portretizonim figurën apo personalitetin e profesor Ahmet Malokut me pika të shkurta do të dukej kësi soji:

Ahmet Shaqë Maloku, i lindur 1929 vdesë 1999 me profesion magjistër i shkencave të kimisë, me vokacion folklorist, poet, historian, etnograf,adhurues dhe dashamirë i çdo gjëje kombëtare, atdhetar i pa kompromis, trim, guximtar i vendosur dhe i pa luhatur në qëndrimet e veta intelektuale, pedagog i shquar, polemizues i rreptë, kritik i ashpër. Ata të cilët e kanë njohur në një mënyrë apo tjetër dhe kanë pas rast të rinë me te, me siguri se aspak nuk iu ka dhimbsur koha që e kanë kaluar me te. I tillë ishte profesor magjistër Ahmet Shaq Maloku.

[Kthehu tek Kritika Doreshkrim](#)